



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1090/7 prot

Datë 29/07/2022

V E N D I M
Nr. 731/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29/07/2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “LA PORTA DELA LUCE” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-29280-05-16-2022, me objekt: “Ndërtimi i Rrugëve të Brendshme në PMLAT”, me fond limit 15.833.333 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 06.06.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur” me Nr. REF-29280-05-16-2022, me objekt: “Ndërtimi i Rrugëve të Brendshme në PMLAT”, me fond limit 15.833.333 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 06.06.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “LA PORTA DELA LUCE” SHPK
Adresa: Lagjja “Skenderbej”, zona kadastrale nr.8526, në nr.pasurise 105/30, volum 28, faqe 24, Elbasan.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit

Adresa: Rruga "Liman Kaba", Parku Olimpik, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", neni 24 e vijues, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.05.2022, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-29280-05-16-2022, me objekt: “Ndërtimi i Rrugëve të Brendshme në PMLAT”, me fond limit 15.833.333 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 06.06.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

II.2. Në datën 20.05.2022, operatori ekonomik ankimues “LA PORTA DELA LUCE” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe po më datë 20.05.2022 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar anulimin e procedurës së prokurimit dhe modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 1201/3 prot, datë 23.05.2022, protokolluar me tonën me nr. 1090/3 prot, datë 27.05.2022, autoriteti kontraktor ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe me shkresën nr. 1201/2 prot, datë 23.05.2022 ka vendosur që të pranojë njërin nga pretendimet e ankimuesit dhe konkretisht ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, si më poshtë vijon:

“Komisioni i ngritur sipas urdhrorit nr. 365 me datë 20/05/2022 për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “LA PORTA DELLA LUCE”, konstatoi nga verifikimi i kryer si më poshtë:

Së pari:

Sa i takon pretendimit të parë se në dokumentacionin e publikuar për tenderin në fjalë mungon preventivi i punimeve.

- Konstatohet se, edhe pse është ngarkuar në sistem preventivi i punimeve, për shkak të një problemi teknik, ai nuk është publikuar, e si pasojë operatorët ekonomikë e kanë të pamundur ta kenë këtë dokument. Ky pretendim pranohet nga ana jonë. Për shkak të këtij problemi teknik autoriteti kontraktor do të marrë masa, në bazë të LPP, konkretisht Neni 98 i tij, pika c dhe VKM “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Neni 38, duke proceduar sipas hapave ligjore për anulimin e kësaj procedure.

Së dyti:

Mungesa e preventivit në sistem nuk lejon pasqyrimin e çmimeve për zërat konkret, por kjo pikë do të shqyrtohet nga ana e autoritetit kontraktor. Çmimet e preventivuara janë dhe do të jenë

konform legjislacionit në fuqi në çastin e publikimit të procedurës. Me publikimin e preventivit do të bëhet e mundur dhe verifikimi i numrit të analizës për secilin zë.

Së treti:

Në lidhje me paligjshmërinë e pretenduar për kërkesën specifike për kualifikim për paraqitje të vërtetimit të pagimit të taksave vendore për vitin 2021, si dhe pretendimin se këtë kriter e mbulon formulari i vetëdeklarimit të ofertuesit.

- Referuar legjislacionit në fuqi, pra Nenit 82 të LPP, si dhe Nenit 26 të VKM për MRRPP nuk ka asnjë pengesë ligjore për kërkimin e një dokumenti të tillë. Madje ai sipas pikës 2, neni 82 të LLP mund të kërkohej në çdo kohë nga AK. Për sa kohë që nuk është i ndaluar ligjërisht, ky kriter mbetet legjitim. Duke mos dashur penalizimin e OE të cilët mund të dorëzojnë on-line dokumentacionin e tyre për pjesëmarrje në procedurën e tenderit brenda muajit Maj 2022, është kërkuar vërtetimi për vitin 2021 . Gjithsesi sërish në kuadrin ligjor të plotësimit të formularit të vetëdeklarimit çdo operator është i lirë të plotësojë atë me azhurnimin më të fundit të pagesave të taksave vendore, në mënyrë që të jetë i rregullt me të gjitha parametrat ligjorë në fuqi.

Së katërti:

Në lidhje me pretendimin e OE ankimues se AK ka vendosur kriterin në lidhje me punët e ngjashme, të cilat janë të paparashikuara në LPP:

- LPP, neni 77 "Kërkesat për kualifikim", pika 1 dhe pika 4 lejojnë AK të kërkojë që ofertuesi të ketë aftësi teknike dhe profesionale duke vendosur kriteret të cilat do e sigurojnë AK që ky operator ka përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm të cilësisë. Rrjedhimisht duke qenë se bëhet fjalë për një punë e cila do zbatohet pranë një parku unik në Shqipëri për nga ana e aksesueshmërisë, llojit të terrenit, llojit të punës, etj, siç është Parku i Madh i Liqenit të Tiranës, kërkohej një përvojë e gjithanshme, e afirmuar me eksperiencën të ngjashme edhe në sektorin publik, por edhe në privat.

Së pesti:

Në lidhje me pretendimin se nga të gjitha kategoritë e kërkuara si pikë në licencën e operatorit ekonomik ofertues vetëm kategoria NP4 dhe NP1 janë në përputhje me objektin e prokurimit:

- Mungesa e preventivit i cili nuk është publikuar e bën të pamundur për operatorin ekonomik të jetë 100% i qartë për zërat e punimeve, e në këtë mënyrë edhe mundësinë për të kuptuar përvojën teknike mbi të cilën do duhet të jetë i licencuar ky subjekt. Gjithsesi pretendimet e ankimuesit do të shqyrtohen nga ana e autoritetit kontraktor. Sërish sqarojmë se duke qenë se bëhet fjalë për një vendndodhje si Parku i Madh i Liqenit të Tiranës, ku ka një terren specifik në lidhje me të cilin mungon çfarëdolloj studimi hidroteknik i ujerave të brendshëm, ku gjithashtu ka një nevojë të vazhdueshme drenazhimi e një sërë problematikash të tjera unike për një zonë aq të veçantë si ajo. Sipërmarrësi i punimeve duhet të jetë mjaftueshëm i kualifikuar teknikisht

për të mbuluar çdo lloj problematike që lidhet me atë zonë. Pra është e nevojshme të kërkohet kategoria NP5, NP6, NP9. Sa i takon pikave që sipas ankimesit nuk përkojnë me mbulimin e zërave të preventivit (të cilin nuk e ka parë) do të shqyrtohen nga ana e AK, në momentin që do të publikohet edhe preventivi i punimeve.

Së gjashti:

Në lidhje me pretendimin e OE ankimes se krijohet konfuzion në lidhje me kriterin sipas së cilit kërkohet nëpërmjet një deklarate pasja e një drejtuesi teknik me eksperiencë 10 vjeçare, për të cilin të paraqitet një CV:

- Në lidhje me këtë pretendim, ju bëjmë me dije se kuadri ligjor, i cili legjitimon një individ të kryejë rolin e një drejtuesi teknik të një shoqërie nuk duhet konfunduar me kuadrin ligjor për prokurimet publike. Këto janë dy fusha të ndryshme veprimtarie, të cilat na drejtojnë në mënyrën se si të ndërlihim eksperiencën teknike të një shoqërie me kriteret të legjitimuara duke mbrojtur në fund të fundit interesin publik për të cilin po punojmë. Në këtë frymë, duke qenë se ka konfuzion në këtë pikë, sqarojmë se edhe pse ligjërisht një eksperiencë 5 vjeçare të lejon të jesh një Drejtues Teknik, mbetet në diskrecionin e AK të vlerësojë bazuar në llojin e punës që prokuron, si dhe zërave të preventivuar (gjë që momentalisht është e paaksesuar nga OE) se sa eksperiencë përtej 5-vjeçarit duhet të ketë drejtuesi teknik. Kjo sepse sikurse u citua edhe më lartë edhe pse në dukje një punë e zakonshme, kemi të bëjmë me një zonë e cila herë pas here sjell problematika për shkak të terrenit ende të pastudiuar gjeologjikisht për një pasqyrim teknik. Kjo është edhe arsyeja e kërkimit të një CV-je.

Së shtati:

Në vazhdim OE ankimes citon pretendimet e tij në lidhje me stafin teknik (konkretisht nga pika shtatë e ankimit deri në pikën e njëmbëdhjetë) të nevojshëm për këtë procedurë prokurimi.

- Autoriteti kontraktor do të marrë në shqyrtim këto pika, duke pasur në konsideratë edhe publikimin e preventivit të munguar, i cili shkakton konfuzion për OE. Llogaritja e numrit të punonjësve bëhet mbi bazën e zërave të preventivit dhe manualit përkatës bashkë me analizat e çmimeve për zërat që nuk janë në manual.

Së teti:

Në lidhje me pretendimin e dymbëdhjetë të OE ankimes ku ankimohet kërkimi i listëpagesave për vitet 2019-2021:

- Listëpagesat, në ripublikimin e procedurës do të përputhen me kohën në të cilën do të rishillohet tenderi.

Së nënti:

Në pretendimin e trembëdhjetë të OE ankimes në lidhje me kriteret specifike për kualifikim ku nga AK janë kërkuar 32 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik.

- Në mënyrë që ofertuesit të vihen në kushte të barabarta ofertimi, do të shqyrtohet kjo pikë nga AK në përputhje me zërat e preventivit të munguar, duke sqaruar edhe nevojën e stafit teknik të kualifikuar.

Së dhjeti:

Sa i takon pretendimit të katërmbëdhjetë të ankimuesit në lidhje me diplomën dhe kualifikimin përkatës dhe numrit të manovratorëve.

- AK ka kërkuar diplomën dhe kualifikimin përkatës. Pra për inxhinierët duhet diploma, për specialistët kualifikimi që kanë. Saktësimi i numrit të manovratorëve do të merret parasysh nga AK.

Së njëmbëdhjeti:

Sa i takon pretendimit të pesëmbëdhjetë të OE ankimues, në lidhje me makineritë dhe pajisjet e kërkuara, nevojës për saktësim në lidhje me pronësinë e tyre, mënyrën e aksesimit në Park, etj :

- AK, do të jetë transparent në momentin e publikimit të preventivit, i cili do të qartësojë edhe lidhjen ndërmjet mjeteve që kërkohen me zërat e punimeve të preventivuara. Mjetet janë kërkuar ose me qira ose në pronësi në mënyrë që të mos ketë diskriminim. Për t'ju qartësuar, objekti i prokuruar do të ndërtohet në hyrje të Ligenit Artificial, nga ana veriore pranë Fakultetit Gjeologji dhe Miniera, dhe nuk ka akses në brendësi të PMLAT. Rruga do ketë një gjerësi prej 3.5 m.

Së dymbëdhjeti:

Operatori ekonomik ankimues ka kërkuar shpjegim në lidhje me certifikimin ISO dhe disponimin e tyre nga secili OE në rast bashkimi operatorësh.

- Sa i takon certifikimit të operatorëve, kjo kërkesë do të shqyrtohet nga ana e autoritetit kontraktor duke u marrë parasysh në përputhje me zërat e preventivuar sipas preventivit që do të publikohet në ripublikimin e kësaj procedure. Në varësi të ndarjes së zërave për secilin OE të bashkimit të operatorëve që marrin pjesë si JV në tender, do të kërkohen për secilin edhe certifikimet përkatëse.

Së trembëdhjeti:

OE ankimues në pikën e tetëmbëdhjetë të ankimit ka kërkuar sqarim mbi bazën ligjore të cituar në lidhje me grafikun e punimeve, i cili duhet të jetë në përputhje me zërat e punimeve dhe në përputhje me afatet kohore të publikuara në DST.

- Si lapsus është cituar Ligji i Vjetër LPP, por sigurisht do të korrigjohet edhe kjo pjesë me ripublikimin e procedurës me preventivin bashkëlidhur dhe çdo kriter bazuar në legjislacionin në fuqi.

Së katërmbëdhjeti:

Për të gjitha pikat në vijim të cilat OE ankimues citon, mbi të cilat paraqet paqartësi mbi planorganizimin (pika e nëntëmbëdhjetë e kërkesës) numri i punonjësve, makineritë (pika e njëzet e një), zërat e grafikut të punimeve (pika e njëzet e dy).

- Sqarojmë se do të jenë pika të arsyetuara nga ana e AK në lidhje me preventivin që momentalisht mungon, duke bërë të mundur që ri-publikimi i kësaj procedure të ketë një përqasje të plotë të kritereve me atë preventiv dhe legjislacionin në fuqi.

Së fundmi:

Sa i takon pretendimit të njëzet të OE ankimues në lidhje me deklaratën mbi mënyrën e financimit të objektit:

- Sipas Nenit 77 të LPP, legjitimohet AK të kërkojë çfarëdolloj dokumentacioni, i cili do të “bindë” atë që OE ofertues ka kapacitet financiar për të mbuluar një punë. AK në zbatim të gjithë kuadrit ligjor në fuqi mbulohet me fonde të parashikuara për çdo zë prokurimi të miratuara me VKB, si dhe sipas regjistrave përkatës të publikuar në SPE. Zotërimi i fondeve për AK nuk është një problematikë që i takon OE, pasi ka ligje të posaçme që orientojnë institucionet për garantimin e fondeve të tyre.

Në lidhje me gjithë sa më sipër, në zbatim të LPP, konkretisht Neni 98 i tij, pika c dhe VKM për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik Neni 38 AK do të marrë masat për anulimin e kësaj procedure, duke bërë të mundur ri-publikimin e saj me kriteret e rishqyrtuara sa më lartë cituar, pas vendimit të KPP.

Ju faleminderit. “.

II.6. Sa më sipër, lidhur me shqyrtimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor, më datë 06.06.2022 operatori ekonomik ankimues ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion shtesë dhe sqarues lidhur me këtë përgjigje të autoritetit kontraktor.

II.7. Komisioni gjatë shqyrtimit të pretendimeve të ankimuesit dhe argumenteve të dhënë nga ana e autoritetit kontraktor konstatoi se krahas informacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor me shkresën nr. 1201/3 prot, datë 23.05.2022, për një shqyrtim sa më të plotë të pretendimeve të ankimuesit i kërkoi autoritetit kontraktor me shkresën nr. 1090/4 prot, datë 04.07.2022 “Rikërkesë për paraqitje dokumentacioni lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “La Porta Della Luce” SHPK” që t’i vihen në dispozicion nga ana e autoritetit kontraktor një informacion i hollësishëm mbi procesin e hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, kopje të preventivit që do prokurohet, procesverbalin e argumentimit të fondit limit, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “La Porta Della Luce” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 1201/6 prot, datë 05.07.2022 me objekt: “Kthim përgjigje”, protokolluar me tonën me nr. 1090/6 prot, datë 12.07.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik preventivi i punimeve, procesverbali “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve

teknike dhe kriterëve për kualifikim”, si dhe shkresa nr. 953/6 prot, datë 22.05.2022 “Rekomandim në lidhje me ankesën e shoqërisë ‘LA PORTA DELLA LUCE’ ShPK” drejtuar titullarit të autoritetit kontraktor.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “LA PORTA DELLA LUCE” ShPK ku kërkon: “Pra, pika e parë e ankesës, kërkojmë nga KPP të na sqarojë përse për këtë tender nuk është publikuar asnjë preventiv? Pra, si do të ofertojnë shoqëritë pjesëmarrëse në kushtet kur preventivin e di vetëm AK dhe nuk është bërë publik? Nga ta dinë shoqëritë pjesëmarrëse që çfarë zërash kanë për të realizuar ky AK? Si do të jepen ofertat nga shoqëritë pjesëmarrëse, në kushtet kur nuk është publikuar preventivi i objektit? Kjo për faktin se, nuk mund të ketë asnjë justifikim që harruam ta hedhim preventivin, ndërkohë që ky preventiv nuk ekziston në dokumentet e tenderit?.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me shkresën nr. 1201/2 prot, datë 23.05.2022, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni përkatës i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe vendimi për trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “LA PORTA DELLA LUCE” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar këtë pretendim të ankimuesit duke u shprehur si në vijim: “ [...]Së pari: Sa i takon pretendimit të parë se në dokumentacionin e publikuar për tenderin në fjalë mungon preventivi i punimeve.

- Ky pretendim pranohet nga ana jonë. Për shkak të këtij problemi teknik autoriteti kontraktor do të marrë masa, në bazë të LPP, konkretisht Neni 98 i tij, pika c dhe VKM “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Neni 38, duke proceduar sipas hapave ligjore për anulimin e kësaj procedure. [...]”.

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 1090/2022 prot, datë 17.05.2022 e operatorit ekonomik “LA PORTA DELLA LUCE” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “LA PORTA DELLA LUCE” ShPK ku kërkon: “Së dyti, kërkojmë nga AK dhe KPP të na sqarojë dhe argumentojë se si ka dalë kjo vlerë e fondit limit, pasi referuar manualit të çmimeve, kjo vlerë del rreth 7,851,000 lekë pa TVSH, pra kërkojmë të dimë se si i ka dalë vlera e fondit limit, referuar manualit të çmimeve të ndërtimit, në fuqi në kohën kur është bërë përlllogaritja e vlerës së fondit limit të kësaj procedure prokurimi.

Kërkojmë nga KPP të verifikoj mirë edhe se kujt numri analize i janë referuar, cilit manual, të verifikoj nëse i korrespondon numri i analizës së manualit zërit që kërkon AK të realizojë, etj, duke na dhënë njëkohësisht edhe argumentimet përkatëse për këtë fond limit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” është përcaktuar përgjegjësia e autoritetit kontraktor, si më poshtë:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.2.2. Referuar metodës së interpretimit sistematik (*domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik*), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24/1 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së, si dhe neni 1 e 2 i VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar) dhe njëherazi përgjegjës për identifikimin e nevojave për investime blerje mallrash dhe shërbimesh, për përlogaritjen e fondeve të nevojshëm për realizimin e këtyre nevojave, për kohën e përzgjedhur nga ana e tyre për prokurimin e këtyre fondeve, si dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, parashikohet se *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*

KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve (*legitimation ad causam*), pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurave për fitimin e kontratave publike, do ti nënshtrohet kushteve specifike (kriterëve të veçanta të kualifikimit), të cilat duhet të përmbushin parakushtin *sine qua non* të parashikuar nga neni 77 i ligjit 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, *Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.* Në rastin konkret, KPP gjykon se autoriteti

kontraktor përgjegjës për identifikimin e nevojave për investime, blerje mallrash dhe shërbimesh, për përllogaritjen e fondeve të nevojshëm për realizimin e këtyre nevojave, për kohën e përzgjedhur nga ana e tyre për prokurimin e këtyre fondeve, hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik, si dhe për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit) duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2021 "Për prokurimin publik", dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik ku në nenin 118 gërma b të *lex specialis* parashikohet, se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të *pranimit të ankesës dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;*

Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknik janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi veprime të autoritetit kontraktor, të cilat duhet të jenë në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe që është përgjegjësi e vetë autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë dhe në përgjegjësinë e autoritetit kontraktor identifikimi i nevojave për investime, blerje mallrash dhe shërbimesh, përllogaritja e fondeve të nevojshme për realizimin e këtyre nevojave, koha e përzgjedhur nga ana e tyre për prokurimin e këtyre fondeve, hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik, realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, gjithmonë në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, por në rastin konkret edhe në përputhje me përcaktimet e VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", i ndryshuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "LA PORTA DELLA LUCE" ShPK ku kërkon: "*Së treti, në kërkesat specifike për kualifikim, AK ka kërkuar që të paraqitet në tender vërtetim për taksat vendore për vitin 2021. Ndërkohë, referuar datës se kur hapet kjo procedurë prokurimi, pra në muajin Qershor 2022, atëherë të gjitha shoqëritë pjesëmarrëse në tender duhet të kenë paguar edhe këstin e maturuar të radhës për vitin 2022, i cili ka patur afat ligjërisht për tu paguar deri në muajin Maj.*

Pra, AK kërkon taksa vendore për vitin 2021, ndërkohë që sipas kësaj kërkesë për kualifikim, edhe në rast se ke detyrime në vitin 2022, i bie të kualifikohesh, sepse kështu e kërkon AK ndërkohë që ligjërisht duhet të skualifikohesh, sepse nuk ke paguar detyrimet për taksat vendore. Gjithashtu, i bëjmë me dije AK se, kërkesa që shoqëritë pjesëmarrëse duhet të paraqesin vërtetim është diskriminuese, antiligjore, pasi një kriter i tillë plotësohet nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit, shkelje e rëndë kjo e ligjit të prokurimit publik.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në Shtojcën 7 “**FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” pika 2.3.3 “*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë:

“2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021, pranë njësisve vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.”.

III.3.1. Në procesverbalin e datës 16.05.2022 “**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**” të publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor është argumentuar vendosja e këtij kriteri kualifikues si më poshtë vijon:

“2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021, pranë njësisve vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.”.

III.3.2. Lidhur me këtë pretendim të ankimuesit autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1201/2 prot datë 23.05.2022 është shprehur se: “Së treti: Në lidhje me paligjshmërinë e pretenduar për

kërkesën specifike për kualifikim për paraqitje të vërtetimit të pagimit të taksave vendore për vitin 2021, si dhe pretendimin se këtë kriter e mbulon formulari i vetëdeklarimit të ofertuesit.

- Referuar legjislacionit në fuqi, pra Nenit 82 të LPP, si dhe Nenit 26 të VKM për MRRPP nuk ka asnjë pengesë ligjore për kërkimin e një dokumenti të tillë. Madje ai sipas pikës 2, neni 82 të LLP mund të kërkohet në çdo kohë nga AK. Për sa kohë që nuk është i ndaluar ligjërish, ky kriter mbetet legjitim. Duke mos dashur penalizimin e OE të cilët mund të dorëzojnë on-line dokumentacionin e tyre për pjesëmarrje në procedurën e tenderit brenda muajit Maj 2022, është kërkuar vërtetimi për vitin 2021 . Gjithsesi sërish në kuadrin ligjor të plotësimit të formularit të vetëdeklarimit çdo operator është i lirë të plotësojë atë me azhornimin më të fundit të pagesave të taksave vendore, në mënyrë që të jetë i rregullt me të gjitha parametrat ligjorë në fuqi.”, duke mos pranuar këtë pretendim të ankimuesit.

III.3.3. Në nenit 76, pika 2 “Kriteret detyruese për skualifikim” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve, kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.”.

Ndërsa ne nenin 82, pika 1 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.”.

III.3.4. Në nenin 43, pika 6 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.”.

Në nenin 26, pika 2 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.”.

III.3.4.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për sa i përket periudhës kohore për të cilën kërkohet që ofertuesi të vërtetojë se nuk ka detyrime të papaguara për taksat vendore në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit që i përkasin kësaj periudhe, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është një kërkesë që nuk krijon siguri lidhur me faktin se operatorët ekonomike i kanë kapacitete ekonomike dhe financiare për realizimin e kontratës, pasi është kërkuar që ofertuesit të paraqesin vërtetim për pagimin e taksave vendore për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit sipas ekstraktit të regjistrit tregtar për gjithë vitin 2021, ndërkohë që procedura e prokurimit zhvillohet më datë 06.06.2022 dhe për periudhën janar-maj 2022 nuk kërkohet asnjë dokument që të provojë se ofertuesit nuk kanë detyrime të maturuara të papaguara për taksat vendore prandaj autoriteti kontraktor me rishpalljen e kësaj procedure prokurimi duhet të kërkojë që ofertuesit të vërtetojnë që nuk kanë detyrime të papaguara për taksat vendore të maturuara për periudhën nga muaji janar 2022 dhe deri në datën e zhvillimit të procedurës së re të prokurimit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.3.4.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për plotësimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 të “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ky kriter kualifikues mund të plotësohet paraprakisht nga ofertuesit nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit si një mekanizëm ligjor që ka sjellë risi në fushën e prokurimeve publike dhe që në këtë rast është një nga kriteret kualifikuese që mund të plotësohet paraprakisht nëpërmjet dorëzimit të këtij formulari sipas parashikimeve të nenit 26, pika 2 të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, prandaj autoriteti kontraktor duhet të modifikojë këtë kriter kualifikues, duke pranuar paraprakisht dorëzimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “LA PORTA DELLA LUCE” ShPK ku kërkon: “Së katërti, në lidhje me kërkesën për punë të ngjashme, AK ka kërkuar dokumentacion si për rastin e kontratave të realizuara me sektorin publik, ashtu edhe për rastin për kontratat e realizuara me sektorin privat, duke kërkuar dokumente, të cilat nuk janë të parashikuara si kërkesa në asnjë prej rasteve të LPP, për më tepër, edhe referuar rastit të kontratave të realizuara me sektorin privat.

Në gjykimin tonë, kjo kërkesë për kualifikim është diskriminuese, evazive dhe në kundërshtim me ligjin, pasi dokumentacioni që AK ka kërkuar për plotësimin e këtij kriteri, nuk gjen mbështetje ligjore.

Referuar procesverbalit të argumentimit të kriterëve për kualifikim, të bërë publik nga AK, rezulton se dispozitat që AK ka vendosur, nuk e parashikojnë një gjë të tillë, se çfarë dokumentacioni duhet të kërkohet dhe përse duhet të kërkohet ky dokumentacion, i cili nuk gjen mbështetje ligjore. Në kushtet kur, vetë AK nuk e ka argumentuar këtë kriter, sjell për analogji vendosjen e një kriteri diskriminues dhe antiligjor, dhe sjell si pasojë anulimin e menjëhershëm të tenderit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në Shtojcën 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë:

“1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentet e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/ët ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Faturat tatimore të prera për objektin

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/ët ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

- Kontratë Sipërmarrje;

- Situacionin përfundimtar;

- Aktin e kolaudimit;

- Faturat tatimore përfundimtare.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit secila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”).”.

III.4.1. Në procesverbalin e datës 16.05.2022 “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor është argumentuar vendosja e këtij kriteri kualifikues si më poshtë vijon:

“Argumentimi: Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, neni 55 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

III.4.2. Lidhur me këtë pretendim të ankimuesit autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1201/2 prot, datë 23.05.2022 është shprehur se: “Në lidhje me pretendimin e OE ankimues se AK ka vendosur kriterin në lidhje me punët e ngjashme, të cilat janë të paparashikuara në LPP:

- LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 1 dhe pika 4 lejojnë AK të kërkojë që ofertuesi të ketë aftësi teknike dhe profesionale duke vendosur kritere të cilat do e sigurojnë AK që ky operator ka përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm të cilësisë. Rrjedhimisht duke qenë se bëhet fjalë për një punë e cila do zbatohet pranë një parku unik në Shqipëri për nga ana e aksesueshmërisë, llojit të terrenit, llojit të punës, etj, siç është Parku i Madh i Liqenit të Tiranës, kërkohet një përvojë e gjithanshme, e afirmuar me eksperiencë të ngjashme edhe në sektorin publik, por edhe në privat.”, duke mos pranuar këtë pretendim të ankimuesit.

III.4.3. Në nenit 77, “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.4.4. Ndërsa në nenin 39, pika 5 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë vjetëve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve”.

III.4.4. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për sa i përket dokumentacionit provues që duhet të dorëzojnë ofertuesit për të provuar se kanë realizuar punime të ngjashme ose me sektorin publik ose me sektorin privat, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ka parashikuar të drejtën e autoriteteve kontraktor që të përcaktojnë dokumentacionin konkret që duhet të dorëzojnë ofertuesit për të vërtetuar që kanë realizuar punime të ngjashme, vlerën, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, ndërkohë që ankimuesi në pretendimin e tij nuk jep asnjë argument se përse këto dokumente të përcaktuara në kriterin kualifikues të pikës 2.3.1 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit janë diskriminuese, ndërkohë që vetë dispozita e

sipërpërmendur ka parashikuar të drejtën e autoriteteve kontraktore për të përcaktuar dokumentacionin konkret që duhet të paraqesin ofertuesit për të vërtetuar se kanë realizuar punime të ngjashme me objektin e prokurimi, dhe për më tepër që dokumentacioni i përmendur në këtë kriter si; formulari i vlerësimit, kontrata e sipërmarrjes, situacionin përfundimtar, aktin e kolaudimit dhe faturat tatimore janë dokumente që pasqyrojnë kërkesat e bazës ligjore të sipërpërmendur, prandaj ky pretendim i ankimuesit nuk qëndron.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “LA PORTA DELLA LUCE” ShPK ku kërkon: “Së pesti, në lidhje me kategoritë e kërkuara në licencës e shoqërisë, del qartazi që AK nuk do të zhvillojë një procedurë të hapur. Sipas kategorive të licencës së kërkuar del qartazi që kategoritë e kërkuara nuk kanë asnjë lidhje me objektin e prokurimit. Pothuajse të gjitha kategoritë e licencave të kërkuara janë diskriminuese, evazive, të marra copy paste, të cilat ulin konkurrencën në prokurim, si dhe në kundërshtim haptazi me Vendimin nr. 42, datë 16.01.2008, konkretisht si më poshtë vijon:

Kërkohet kategoria NP-2, kategori e cila ka të bëjë me ndërtime civile dhe industriale.

Nuk e kuptojmë se çfarë ndërtimi të ri do të bëhet, se mbase nuk e kuptojnë mirë edhe AK, ndërkohë që objektin e prokurimit e ka për ndërtim rruge të brendshme.

A e di AK se kategoria NP-2 përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim specifik në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavanëve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

Pra, nuk e kuptojmë po tenderohet rrugë apo godina banimi?

KPP në këtë rast nuk duhet të mjaftohet vetëm me modifikimin e këtij kriteri, por të hetohet edhe me thellë, se përse po kërkohen kategori për objekte banimi, pra mbase nuk duan të bëhet vetëm një rrugë por edhe ndonjë pallat.

Nuk e kuptojmë se çfarë rikonstruksioni objekti do të bëjë AK, ndërkohë që po tenderon ndërtim rruge. Atëherë, përse e kërkon kategorinë NP-3?

A e di AK se, kategoria NP-3 përfshin Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash?

Pra, AK duhet ti vërtetojë dhe tregojë KPP se çfarë objekti do të bëhet rikonstruksion, ku është ky objekt, sepse nuk e ka kërkuar kot këtë pikë licence.

A e di AK se kategoria NP-5 ka të bëjë me galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele. Në dijeninë tonë mesa kemi parë tek zërat e grafikut të punimeve dhe në DST, shikojmë që AK nuk do të hapë asnjë tunel dhe galeri natyrore, por kërkon të bëjë ndërtimin e rrugëve të brendshme.

Pra, AK duhet ti tregojë dhe vërtetojë KPP se ku do ti hapi tunelet dhe galeritë natyrore.

Pra, jo më kot i ka kërkuar AK që shoqëria duhet të jetë e licencuar për hapje tunelesh, por të paktën të na tregojë se ku do hapen.

Në lidhje me kategorinë NP-6 të kërkuar, sqarojmë se kjo kategori ka të bëjë me ndërtimin e digave, dhe mesa shohim në dokumentet e tenderit të kësaj procedure, nuk po ndërtohet ndonjë digë.

Po atëherë, përse e ka kërkuar AK që duhet të jesh i licencuar për ndërtimin e digave?

Duke qenë se AK e kërkon që shoqëria duhet të jetë e licencuar për ndërtimin e digave, të na tregojë se ku do të ndërtohet diga në këtë objekt?

Në lidhje me kategorinë NP-7 të kërkuar, rezulton se kjo kategori ka të bëjë me ndërtimin e ujësjellësve dhe gazsjellësve, si dhe në dijeninë tonë mesa shohim në DST kërkohet të asfaltohen vetëm rrugët e brendshme dhe jo të ndërtohet ndonjë ujësjellës?

Atëherë, përse AK e ka kërkuar këtë kriter, kur nuk po ndërton asnjë ujësjellës?

Mos vallë po ndërtoni ndonjë gazsjellës, referuar kjo edhe kushteve aktuale, prandaj ju duhet shoqëria e licencuar?

Në lidhje me kategorinë NP-8 të kërkuar, rezulton se kjo kategori ka të bëjë me portet, molet bankinant dhe mesa shohim në DST nuk po ndërtohet ndonjë port. Atëherë përse e kanë kërkuar?

KPP duhet të na sqarojë hollësisht që përse janë kërkuar?

Në lidhje me kategorinë NP-9 të kërkuar, rezulton se kjo kategori ka të bëjë me kanalet lundruese, grykë derdhjet e lumenjve, nuk e kuptojmë se çfarë lidhje ka me objektin konkret të prokurimit për ndërtimin e rrugëve të brendshme.

AK ka kërkuar edhe kategorinë NP-10, kategori e cila ka të bëjë me hidrocentralet dhe termocentralet dhe nuk e kuptojmë përse është kërkuar, pasi në dijeninë tonë në DST nuk ka ndonjë hidrocentral tek objekti i kësaj procedure prokurimi. KPP duhet të na sqarojë hollësisht që përse janë kërkuar?

AK ka kërkuar kategorinë NS-2, e cila ka të bëjë me impiante hidrosanitare, lavaxteri, kuzhina dhe nuk e shohim këtë zë në asnjë vend të DST të publikuara.

AK ka kërkuar edhe kategorinë NS-3, pra për ashensorë por nuk e kuptojmë se ku do të montohet ashensori, pasi rruga është horizontale. KPP duhet të na sqarojë hollësisht që përse janë kërkuar?

AK ka kërkuar edhe kategoritë NS-5 dhe NS-6 të cilat kanë të bëjnë me impiante të sinjalistikës, ndërkohë që tek grafiku i punimeve nuk kanë asnjë zë të tillë.

E njëjta gjë vlen për analogji për të gjitha kategoritë NP dhe NS të kërkuara, ku vetëm kategoria NP 1 dhe NP 4 është në përputhje me objektin e prokurimit, kurse të gjitha kategoritë e tjera të kërkuara janë diskriminuese, të cilat kanë vetëm një qëllim, uljen e konkurrencës në prokurim.

Pra sipas kategorive të kërkuara, vetëm kategoria NP-4 ka të bëjë me këtë objekt prokurimi dhe NP1, kurse të gjitha kategoritë e tjera të kërkuara janë diskriminuese dhe ulin konkurrencën në Prokurim duke mos i vendosur ofertuesit në kushte të barabarta konkurrimi dhe vlerësimi.

Kërkojmë tani nga KPP, duke qenë se AK ka bërë edhe miratimin e kriterëve për kualifikim, të sqarojnë se si e ka bërë miratimin e procesverbalit AK, të cilat sjellin për analogji një tender diskriminues, i cili duhet të anulohet menjëherë.

Për këtë pikë, kërkojmë sqarim të hollësisht dhe argumentim për secilën prej kategorive të kërkuara, në rast se do të lihen nga KPP-ja.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në Shtojcën 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” pika 2.3.2 “*Kapaciteti Teknik*” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë:

“2. *Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.*

Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se disponon licencë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “ Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

a. Licenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

Për punime të përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- *NP-1 A Punime gjurmimi në tokë.*
- *NP-2 A Ndërtime civile e industriale.*
- *NP-3 A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash.*
- *NP-4 A Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tranvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.*
- *NP-5 A Punime nëntokësore*
- *NP-6 A Diga dhe tunele hidroteknike.*
- *NP-7 A Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.*
- *NP-8 A Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.*
- *NP-9 A Punime mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime*
- *NP-10 A Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjise elektrike*
- *NP-11 A Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike*
- *NP-12 A Punime të inxhinjerisë mjedisore*

Për punimet speciale të ndërtimit kompania duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- *NS-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve*
- *NS-2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre*
- *NS-3 A Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)*
- *NS-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.*
- *NS-5 A Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut*
- *NS-6 A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese*
- *NS-7 A Barriera dhe mbrojtje rrugore*
- *NS-8 A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri*
- *NS-9 A Punime strukturore speciale*
- *NS-10 A Shtresa dhe mbistruktura speciale*
- *NS-11 A Punime në shina dhe traversa*

- NS-12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
- NS-13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
- NS-14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV
- NS-15 A Pastrimi i ujërave detar, liqenore dhe lumorë
- NS-16 A Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij
- NS-17 A Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane
- NS-18 A Punime topogjeodezike
- NS-19 A Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë
- NS-20 A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë: sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës.

Operatorët ekonomikë duhet të kenë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore”.

Operatorët e huaj duhet të barazvlerësojnë (ekuivalentojnë) licencat profesionale që ata kanë të lëshuar nga vendi i origjinës, në Institucionet përgjegjëse, në Republikën e Shqipërisë..”.

III.5.2. Në procesverbalin e datës 16.05.2022 “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor është argumentuar vendosja e këtij kriteri kualifikues si më poshtë vijon:

“**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, autoriteti kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.”.

III.5.3. Lidhur me këtë pretendim të ankimuesit autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1201/2 prot, datë 23.05.2022 është shprehur se: “Së pesti: Në lidhje me pretendimin se nga të gjitha kategoritë e kërkuara si pikë në licencën e operatorit ekonomik ofertues vetëm kategoria NP4 dhe NPI janë në përputhje me objektin e prokurimit:

- Mungesa e preventivit i cili nuk është publikuar e bën të pamundur për operatorin ekonomik të jetë 100% i qartë për zërat e punimeve, e në këtë mënyrë edhe mundësinë për të kuptuar përvojën teknike mbi të cilën do duhet të jetë i licencuar ky subjekt. Gjithsesi pretendimet e ankimuesit do të shqyrtohen nga ana e autoritetit kontraktor. Sërish sqarojmë se duke qenë se bëhet fjalë për një vendndodhje si Parku i Madh i Liqenit të Tiranës, ku ka një terren specifik në

lidhje me të cilin mungon çfarëdolloj studimi hidroteknik i ujërave të brendshëm, ku gjithashtu ka një përvojë të vazhdueshme drenazhimi e një sërë problematikash të tjera unike për një zonë aq të veçantë si ajo. Sipërmarrësi i punimeve duhet të jetë mjaftueshëm i kualifikuar teknikisht për të mbuluar çdo lloj problematike që lidhet me atë zonë. Pra është e nevojshme të kërkohet kategoria NP5, NP6, NP9. Sa i takon pikave që sipas ankimuesit nuk përkojnë me mbulimin e zërave të preventivit (të cilin nuk e ka parë) do të shqyrtohen nga ana e AK, në momentin që do të publikohet edhe preventivi i punimeve.”, duke mos pranuar këtë pretendim të ankimuesit.

III.5.4. Në nenit 77, pika 1, 2 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.5.5. Ndërsa ne nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.5.6. Ndërsa Kreun IX “DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË USHTROJNË VEPRIMTARI NDËRTIM”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Pjesë e kësaj rregulloreje janë lidhjet 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7.”

Ndërsa në Lidhjen 3 janë përshkrimet e kategorive të punimeve të ndërtimit si më poshtë:

LIDHJA 3

Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme

N.P. 1 Punime gjërmimi në tokë

Konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.

N.P. 2 Ndërtime civile e industriale

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavanëve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

N.P. 3 *Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash*

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

N.P. 4 *Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.*

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

N.P. 5 *Punime nëntokësore*

Konsiderohen. Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntoke që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi “goma” ose mbi “hekur”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

N.P. 6: *Diga dhe tunele hidroteknike.*

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, që janë të nevojshme për të ruajtur ujin e grumbulluar të zbatuar për çfarëdo lloj motivi, të lokalizuara në drejtim të rrjedhjes.

Përfshin diga të ndërtuara me çfarëdo lloj materiali.

N.P. 7: *Ujësjellësi, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje*

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të

pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

N.P. 8 *Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë*

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta të realizuara në ujëra të ëmbla ose të kripura, që i përkasin terminaleve “ujore” ose vepra mbrojtëse territori nga ujërat detare ose të ëmbla, e kompletuar me veprat lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe të tipit të veçantë për të pasur një shërbim të mirë të përdoruesit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar portet, molet, bankinat, panelet, platformat, pontilet, mbrojtje detare, shkëmbinj nënujore, ujësjellsat nënujore, vepra shkarkimi, si edhe punime të drenimit e thellimi në det të hapur, në pellg ujëmbledhës, të mbrojtjes kundër erozionit nga ujërat e ëmbla ose të kripura.

N.P. 9 *Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.*

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafrangmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.

N.P.10 *Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike*

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, ose që janë të nevojshme për prodhimin e energjisë elektrike, të kompletuara me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit, përfshirë edhe të gjitha impiantet mekanike, elektromekanike elektrike, telefonike, elektronike, të nevojshme për funksionim, sigurim dhe asistencë.

Përfshin hidrocentralet dhe termocentralet.

N.P.11 *Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.*

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

N.P. 12 *Punime të inxhinierisë mjedisore*

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të

qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurorë, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

SHPJEGIME PËR KATEGORITË E NDËRTIMEVE (PUNIMEVE) SPECIALE

N.S –I Punime për prishjen e ndërtimeve

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

N.S-2 Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S-3 Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve transportuese, ashensorë, shkallë të lëvizshme, ngritëse dhe të transportit, komplet dhe të lidhur me çdo punim murature plotësuese ose ndihmëse që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

N.S – 5 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike dhe ristrukturimi i impiantit automatik për sinjalistikën ndriçuese dhe sigurinë e trafikut rrugor, hekurudhor, të metrosë ose

tramvajit, përfshi përpunimin e informacionit dhe të dhënave.

N.S - 6: Sinjalistika rrugore jondriçuese

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.

N.S – 7 Barriera dhe mbrojtje rrugore

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja ristrukturimi i elementeve si guard rail, new jersey, zvogëluesit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa.

N.S – 8 Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri

Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur.

Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër.

Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.

N.S- 9 Punime strukturore speciale

Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotave të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilota ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përfshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratorit nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizazione dhe konsolidimin e terreneve.

N.S- 10 Shtresa dhe mbistruktura speciale

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i shtresave (dysHEMEVE) të realizuara me materiale të veçanta, natyrale ose artificiale, të cilat janë me ngarkesa të konsiderueshme, si mund të jenë pistat aeroportuale.

N.S – 11 Punime në shina dhe traversa

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike ristrukturimi i binarëve për çfarëdo lloj hekurudhe, metroje, tramvaji, si edhe sistemin e frenimit dhe automatizimin e stacioneve të mallrave.

N.S - 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit

Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

N.S - 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S- 14 *Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV*

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S.- 15 *Pastrimi i ujerave detar, liqenore dhe lumorë*

Konsiderohet pastrimi me mjete teknike speciale të veçantë të çfarëdo lloj uji dhe të transportit të materialeve që dalin nga pastrimi i tij në vende të caktuara me akte normative.

N.S.- 16 *Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij*

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja, ristrukturimi i impianteve të ujit të pijshëm të ujërave që duhen pastruar, përfshirë edhe grumbullimin e biogazit dhe të prodhimit të energjisë elektrike e kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmës, të veçanta ose në rrjet.

N.S - 17 *Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane*

Konsiderohet zbatimi dhe mirëmbajtja e zakonshme ose jashtëzakonshme, e impiantit të djegies së mbetjeve e lidhur me sistemin e trajtimit të tymrave, e ripërdorimit të materialeve përfshirë makineritë e seleksionimit, kompostimin dhe prodhimin e derivateve të djegshme nga mbetjet, e kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmës, të veçanta ose në rrjet.

N.S - 18 *Punime topogjeodezike*

Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

N.S - 19 *Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë*

Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën me origjinë rrugore, hekurudhore, të barrierave metalike betonarme, dru xham, ose material plastik transparent, të mureve dopio, të mureve poroze ose të tullave poroze, gjithashtu edhe të veshjeve zëizoluese të pareteve të terrenit ose të tuneleve.

N.S- 20 *Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë:*

Përfshihen shpimet për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik. Shpimet për ujë dhe puse.”.

III.5.4.1. Për sa i përket pretendimit të ankimuesit lidhur me kapacitetit teknik të ofertuesve , ku është përcaktuar që të disponojnë licencë për zbatimin e punimeve në ndërtim të lëshuar sipas përcaktimeve të VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të

Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, ku të jenë të licencuar për kategoritë e punimeve NP-2, NP-3, NP-5, NP-6, NP-7, NP-8, NP-9, NP-10, NS-2 dhe NS-6, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij të kërkojë që operatorët ekonomik ofertues të kenë kapacitete teknike për kryerjen e punimeve objekt-prokurimi, por gjithmonë kjo kërkesë duhet të jetë në përputhje dhe proporcion me natyrën e punimeve objekt-prokurimi, ndërsa në rastin konkret disa nga kategoritë e mësipërme të punimeve të ankimuar nuk janë në proporcion me llojin e punimeve referuar preventivit të punimeve, prandaj autoriteti kontraktor kur të rishpallë këtë procedurë prokurimi me të njëjtin preventiv duhet ta modifikojë kriterin kualifikues, duke e hequr kërkesën që operatorët ekonomik ofertues të jenë të licencuar për kategoritë e punimeve NP-2, NP-3, NP-5, NP-6, NP-7, NP-8, NP-9, NS-2 dhe NS-6.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.5.4.2. Për sa i përket pretendimit të ankimuesit se: *“Pra sipas kategorive të kërkuara, vetëm kategoria NP4 ka të bëjë me këtë objekt prokurimi dhe NP1, kurse të gjithë kategoritë e tjera të kërkuara janë diskriminuese dhe ulin konkurrencën në prokurimi, duke mos i vendosur ofertuesit në kushte të barabarta konkurrimi dhe vlerësimi.”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet që të argumentojë teknikisht kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit lidhur me kategoritë e punimeve që duhet të kenë në licencën profesionale ofertuesit, duke u mbështetur në llojin e punimeve referuar zërave të punimeve të përcaktuar në preventiv dhe Lidhjes 3 të VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar, ndërsa për sa i përket këtij pretendimi ankimuesi nuk jep asnjë argument teknik se përse të gjithë kategoritë e tjera të punimeve nuk janë në përputhje me preventivin, por vetëm kategoritë e punimeve NP-1 dhe NP-4, prandaj ky pretendim i ankimuesit qëndron pjesërisht dhe autoriteti kontraktor në rishpalljen e kësaj procedure prokurimi duhet të mbajë parasysht konstatimin e mësipërm të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik *“LA PORTA DELLA LUCE”* ShPK ku kërkon: *“Së gjashiti, në dokumentet e tenderit AK ka kërkuar që kandidati ofertues duhet të deklarojë me një deklaratë drejtuesin teknik të punimeve, ndërkohë që vetë AK nuk ka kërkuar në kërkesat për kualifikim asnjë drejtues teknikë.*

Një kriter i tillë për kualifikim shkakton konfuzion në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse, duke mos i venë ofertuesit në kushte të barabarta konkurrimi dhe vlerësimi.

Nuk e kuptojmë se si mund të kërkohet një deklaratë e tillë, kur vetë AK nuk ka parashikuar se çfarë kërkon..

Gjithashtu, kërkesa që AK ka bërë që duhet të ketë eksperiencë pune 10 vjet është kufizuese dhe në kundërshtim me Vendimin nr. 42, datë 16.01.2008.

Pra, të na sqarojë KPP përse duhet 10 vjet, kur sipas Vendimit nr. 42, bëhesh drejtues teknik me 5 vite. Ku e ka gjetur AK këtë bazë ligjore, duhet parë mirë dhe verifikuar.

Kërkesa që vetëm inxhinieri i deklaruar, pra vetëm njëri duhet të jetë në objekt, sjell si pasojë një kërkesë të paargumentuar, për inxhinierët e tjerë, pasi i bie që të jenë kërkuar në mënyrë evazive dhe antiligjore.

Pra, në rast se një shoqëri paraqet me deklaratë arkitektin, sipas kërkesës për kualifikim vetëm ky duhet të jetë në objekt, atëherë inxhinierët e tjerë janë kërkuar kot, pra të rishikohet kjo kërkesë antiligjore.

Gjithashtu, kërkesa që duhet të paraqitet edhe CV, bie në kundërshtim me udhëzimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, që kërkesa për CV nuk duhet të kërkohet.

Së shtati, AK ka kërkuar në kërkesat për kualifikim, një fjali “Stafi kryesor teknik (i shfaqur në licencën e shoqërisë), punonjësit, certifikonit, i kualifikuar për këto punime”.

Sinqerisht nuk arrijmë të kuptojmë se çfarë është kërkuar, kush është stafi kryesor teknik, kush punonjësit, kush janë certifikimet, kush janë të kualifikuar për këto punë, apo mbase i kanë ngelur nga ndonjë tender tjetër.

Pra, lutemi sqarimin se çfarë ka dashur AK të kërkojë me kërkesën të kualifikuar për këto punë.

Për kë punë e ka fjalën, për punën me këto kërkesa, apo për punën më këto kategori licence....

Lutemi KPP verifikimin mirë të kësaj situate, argumentimet përse u vunë, përse shërbejnë, kush i vuri, çfare i shërbejnë, etj, sqarimin e saktë dhe të duhur ligjor dhe teknik, një përgjigje sa më të drejtë dhe ligjore, pasi përgjegjësia do të jetë shumë e madhe”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në Shtojcën 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT’ pika 2.3.3 “Kapaciteti Teknik” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë:

“3. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i Shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punime në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm si dhe të ketë eksperiencë pune minimumi 10 (dhjetë) vjet.

- Librezë pune (përkatëse)
- CV përkatëse
- Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarime të rreme do të veprohet në përputhje ligjin “Për Prokurimet Publike”.

Stafi kryesor teknik (i shfaqur në licencën e shoqërisë), punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për këto punime.”.

III.6.2. Në procesverbalin e datës 16.05.2022 “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor nuk ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues.

III.6.3. Lidhur me këtë pretendim të ankimuesit autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1201/2 prot datë 23.05.2022 është shprehur se: “**Së gjashti:** Në lidhje me pretendimin e OE ankimues se krijohet konfuzion në lidhje me kriterin sipas së cilit kërkohet nëpërmjet një deklaratë pasja e një drejtuesi teknik me eksperiencë 10 vjeçare, për të cilin të paraqitet një CV:

- Në lidhje me këtë pretendim, ju bëjmë me dije se kuadri ligjor, i cili legjitimon një individ të kryejë rolin e një drejtuesi teknik të një shoqërie nuk duhet konfunduar me kuadrin ligjor për prokurimet publike. Këto janë dy fusha të ndryshme veprimtarie, të cilat na drejtojnë në mënyrën se si të ndërlikohim eksperiencën teknike të një shoqërie me kriteret të legjitimuara duke mbrojtur në fund të fundit interesin publik për të cilin po punojmë. Në këtë frymë, duke qenë se ka konfuzion në këtë pikë, sqarojmë se edhe pse ligjërisht një eksperiencë 5 vjeçare të lejon të jesh një Drejtues Teknik, mbetet në diskrecionin e AK të vlerësojë bazuar në llojin e punës që prokuron, si dhe zërave të preventivuar (gjë që momentalisht është e paaksesuar nga OE) se sa eksperiencë përtej 5-vjeçarit duhet të ketë drejtuesi teknik. Kjo sepse sikurse u citua edhe më lartë edhe pse në dukje një punë e zakonshme, kemi të bëjmë me një zonë e cila herë pas here sjell problematika për shkak të terrenit ende të pastudiuar gjeologjikisht për një pasqyrim teknik. Kjo është edhe arsyeja e kërimit të një CV-je.”,

Së shtati: Në vazhdim OE ankimues citon pretendimet e tij në lidhje me stafin teknik (konkretisht nga pika shtatë e ankimimit deri në pikën e njëmbëdhjetë) të nevojshëm për këtë procedurë prokurimi.

- Autoriteti kontraktor do të marrë në shqyrtim këto pika, duke patur në konsideratë edhe publikimin e preventivit të munguar, i cili shkakton konfuzion për OE. Llogaritja e numrit të punonjësve bëhet mbi bazën e zërave të preventivit dhe manualit përkatës bashkë me analizat e çmimeve për zërat që nuk janë në manual duke mos pranuar këtë pretendim të ankimuesit.”.

III.6.4. Në nenin 77, pika 1, 2 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.6.5. Ndërsa në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.6.6. Në Kreun IV “DREJTUESI TEKNIK I SHOQËRISË DHE PAPAJTUESHMËRIA ME KËTË DETYRË” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË

LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË USHTROJNË VEPRIMTARI NDËRTIM”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Drejtuesi teknik i shoqërisë

a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr. 5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet pas diplomimit në ciklin e dytë të studimeve universitare. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 (tre) vjet pas diplomimit në ciklin e dytë të studimeve universitare.

b) Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

c) Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë rregullohen sipas kontratës individuale të punës, me afat të përcaktuar (jo më pak se 1 (një) vit).

2. Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit

Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punëmarrje tjetër publike.

Kur personat që pranojnë të kryejnë detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë për zbatim disponojnë licencë profesionale mbikëqyrjeje e kolaudim punimesh zbatimi, ata kanë detyrimin për evidentimin e këtij fakti në dokumentacionin e paraqitur për kërkesë, si dhe dorëzimin e kopjes origjinale të këtyre licencave pranë arkivit të sektorit përgjegjës për licencimin, përpara ose në çastin kur shoqëria në fjalë merr licencën.

Licencat profesionale për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, i kthehet personit sapa ai shprehur marrëdhëniet si drejtues teknik me shoqërinë.”.

Ndërsa në Kreun VI “DOKUMENTET QË SHOQËROJNË KËRKESËN PËR LICENCË PROFESIONALE, NDRYSHIME DHE PËRDITËSIME” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË USHTROJNË VEPRIMTARI NDËRTIM”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

“1. Dokumentacionin për pajisje me licencë shoqërie për herë të parë

a) Kërkesa e shoqërisë për pajisje me licencë sipas formularit të paraqitur në lidhjen nr.6. Kërkesës i bashkëlidhet dhe dokumentacioni i mëposhtëm provues:

I. Shfuqizuar.

II. Kopje e njësuar e diplomës së drejtuesit apo drejtuesve teknikë të shoqërisë.

III. Kur drejtuesi teknik është diplomuar me mesatare note nga 9:0 e lart ose ekuivalent dhe kërkon të vendoset si drejtues teknik 3 (tre) vjet pas diplomimit në ciklin e dytë të studimeve universitare, kopje e njësuar e listës së notave.

IV. Dokumentacion teknik justifikues (original ose i njësuar) për veprimtarinë e kryer nga drejtuesi teknik, vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma publikë ose privatë. Kur vërtetimi lëshohet nga institucion privat bashkëshoqërohet dhe me vërtetim të subjektit publik që konfirmon faktin.

V. Kontrata ndërmjet drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, me afat të përcaktuar (jo më pak se 1 (një) vit).

VI. Vetëdeklarimi i drejtuesve ligjorë, nëse është në hetim apo procedim penal me cilësinë e të pandehurit për vepra penale që kanë lidhje me ushtrimin e detyrës, (sipas formatit të lidhjes nr.7/1).

VII. Vetëdeklarim i drejtuesit/ve teknik, nëse është në hetim apo procedim penal me cilësinë e të pandehurit për vepra penale që kanë lidhje me ushtrimin e detyrës apo ka qenë i dënuar, si dhe për gjendjen në lidhje me punëmarrje të tjera, (sipas formatit të lidhjes nr.7/2).”.

III.6.4.1. Për sa i përket pretendimit të ankimuesit lidhur me kërkesën që ofertuesi të deklarojë njërin nga drejtuesit teknik si drejtues teknik të punimeve në objekt, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se kjo kërkesë për kualifikim **ndonëse nuk është argumentuar** nga ana e autoritetit kontraktor referuar procesverbalit të datës 16.05.2022, por gjykon se kjo kërkesë nuk sjell konfuzion, pasi referuar pikës IV të Kreut IV të VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar një nga dokumentet e nevojshme që duhet të paraqesin aplikantët pranë komisionit të licencave për t’u bërë drejtues teknikë është dhe dokumentacioni teknik justifikues për veprimtarinë e kryer nga kandidati, i cili është personi që drejton punimet në kantier dhe merret me zbatimin me korrektësi të preventivit të punimeve sipas zërave të përcaktuar në të, pra kjo kërkesë e autoriteti kontraktor është në përpjesëtim me volumin dhe e objektin e kontratës, pasi vetë ofertuesi nëse shpallet fitues duhet të caktojë një person i cili është përgjegjës për kryerjen e punimeve dhe që mban kontaktet me përfaqësuesin e autoritetit kontraktor, supervizorin e punimeve dhe kolaudatorin e punime për kryerjen me korrektesë të punimeve objekt prokurimi.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.6.4.2. Për sa i përket pretendimit të ankimuesit lidhur kërkesën që drejtuesi teknik i deklaruar nga administratori dhe që do të jetë drejtues teknik i punimeve në objekt nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punime në objekt, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kjo kërkesë jo vetëm nuk është argumentuar nga ana ligjore nga ana e autoritetit kontraktor referuar procesverbalit të datës 16.05.2022, por nga na tjetër është në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2, të Kreut IV të VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar, ku është e përcaktuar që detyra e drejtuesit teknik është në papajtueshmëri me çdo punëmarrje tjetër publike dhe profesionin e supervizorit dhe

kolaudatorit të punimeve, ndërkohë që në asnjë dispozitë të këtij akti nënligjor nuk përcaktohet që drejtuesi teknik i punimeve duhet të jetë gjatë gjithë kohës në objekt dhe për më tepër që nuk duhet të drejtojë punën dhe në objekte të tjera të cilat i ka marrë njëkohësisht për t'i realizuar shoqëria në të cilën ai është drejtues teknik, prandaj ky pretendim i ankimuesit qëndron dhe autoriteti kontraktor në rishpalljen e kësaj procedure prokurimi duhet që të modifikojë kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.4 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit, duke e hequr kërkesën që drejtuesi teknik i deklaruar nga administratori i shoqërisë si drejtues teknik i punimeve nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punime në objekt.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.6.4.3. Për sa i përket pretendimit të ankimuesit lidhur kërkesën që drejtuesi teknik duhet të jetë me eksperiencë punë jo më pak se 10 vjet, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kjo kërkesë jo vetëm nuk është argumentuar nga ana ligjore nga ana e autoritetit kontraktor referuar procesverbalit të datës 16.05.2022, por nga na tjetër është në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1, të Kreut IV të VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar, ku është e përcaktuar që një individ mund të fitojë të drejtën për t'u bërë drejtues teknik në një shoqëri që kryen veprimtari të zbatimit të punimeve të ndërtimit vetëm nëse ka jo më pak se 5 vjet punë pas diplomimit në ciklin e dytë të studimeve universitare, prandaj ky pretendim i ankimuesit qëndron dhe autoriteti kontraktor me rishpalljen e kësaj procedure prokurimi duhet që të argumentojë kërkesën lidhur me vitet e eksperiencës së drejtuesit teknik të shoqërive që do të ofertojnë si dhe duhet që të përcaktojë një eksperiencë punë jo më pak se 5 vjet punë pas diplomimit në ciklin e dytë të studimeve universitare.

Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nisur nga natyra e punimeve të përcaktuara në zërat e preventivit dhe nisur nga projekti i zbatimit të punimeve, autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar se përse një drejtues teknik me eksperiencë pune 10 vjeçare është i nevojshëm për zbatimin e këtyre punimeve objekt prokurimi.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.6.4.4. Për sa i përket pretendimit të ankimuesit lidhur përcaktimin e bërë në kriterin e dhënë në pikën 2.3.4 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit ku autoriteti kontraktor është shprehur si në vijim: “*Stafi kryesor teknik (i shfaqur në licencën e shoqërisë), punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për këto punime.*”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kjo kërkesë jo vetëm nuk është argumentuar nga ana ligjore nga ana e autoritetit kontraktor referuar procesverbalit të datës 16.05.2022, por nga ana tjetër është dhe konfuze dhe e paqartë dhe që sjell konfuzion tek operatorët ekonomikë të cilët kërkojnë të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi dhe për më tepër kjo kërkesë nuk shpreh as qëllimin për të cilin është përcaktuar nga ana e autoritetit

kontraktor, prandaj me rishpalljen e procedurës së prokurimit nga ana e autoritetit kontraktor duhet që hiqet, pasi sjell konfuzion tek ofertuesit dhe nuk është në përpjestim me objektin e prokurimit.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “LA PORTA DELLA LUCE” ShPK ku kërkon: “Së teti, AK kërkon përveç një inxhinieri ndërtimi, shoqëria duhet të ketë drejtues teknikë edhe një strukturist, kërkesë kjo e cila është diskriminuese.

Nuk e kuptojmë se përse në tenderë ndërtimi për objekte ndërtimi APR nuk kërkon inxhinier strukturist, ndërkohë që për ndërtim rruge të brendshme e kërkon edhe një ndërtimi edhe një strukturist, pra dy në total.

A e di AK që për çfarë është i diplomuar inxhinieri strukturist?

Së nënti, AK kërkon që eksperti për ndihmën e parë të jetë vetëm inxhinieri elektrik, po lind pyetja përse, apo kështu duhet. Po përse nuk e keni argumentuar në procesverbalin e mbajtur që duhet të jetë vetëm inxhinier elektrik.

Lutemi na argumentoni se çfarë ndryshimi ka nëse e plotëson këtë pikë një inxhinier tjetër apo ndonjë punonjës tjetër. Apo duhet vetëm inxhinier elektrik? Po arsyeja, apo do ta zbulojë KPP si organi më i lartë në fushën e shqyrtimit të ankesave, pra nëse është apo jo ligjore kjo kërkesë, si dhe përse u vendos.

Lutemi gjithashtu, na sqaroni se kush janë punimet në lartësi që je doni të realizoni.

Mos vallë e quani punim në lartësi sepse keni kërkuar kamion me vinç, apo ngaqë terreni është i lartë në krahasim me nivelin e detit?

Lutemi na sqaroni përse e kërkon dy herë, një herë përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, kurse një herë vetëm për sigurinë kurse një herë për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë. Pra, 3 punonjës të tillë? KPP të na sqarojë ligjërisht dhe teknikisht se sa duhet të kërkohen dhe si argumentohet numri i punonjësve të kësaj kërkesë. Pra, vetë AK nuk po di se çfarë të kërkohet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në Shtojcën 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 2.3.5 “Kapaciteti Teknik” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë:

“5. Stafit ndihmës/mbështetës, certifikimet ose kualifikimet mbështetëse:

- 1 (një) inxhinier elektrik që përmbush kriteret për të qenë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, diploma, CV, librezë pune dhe të figurojë në listpagesa.
- 1 (një) nga inxhinierët pjesë e stafit të shoqërisë, duhet të jenë të pajisur me certifikatën e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, “Përgjegjës për sigurinë”, e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, (në rastin e bashkimit të operatorëve secili operator duhet të paraqesë këtë certifikatë).

- *Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) specialist të certifikuar për “Punime në lartësi”, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë. Detyrimisht të paraqitet kontratë pune dhe certifikata përkatëse e tyre.*
- *1 (një) person që përmbush kriteret për të qenë “Specialist dhe përgjegjës për sigurimin teknik, shëndetin dhe mbrojtjen në punë”, diploma, CV, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesa.*
- *1 (një) person që përmbush kriteret për të qenë “Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, diploma, CV, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesa.”.*

III.7.2. Në procesverbalin e datës 16.05.2022 “*PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM*” të publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues si më poshtë:

“Argumentimi: Ky kriter është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ku citon se fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

III.7.3. Lidhur me këtë pretendim të ankimuesit autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1201/2 prot, datë 23.05.2022 është shprehur se: *“Së shtati: Në vazhdim OE ankimues citon pretendimet e tij në lidhje me stafin teknik (konkretisht nga pika shtatë e ankimimit deri në pikën e njëmbëdhjetë) të nevojshëm për këtë procedurë prokurimi.*

- Autoriteti kontraktor do të marrë në shqyrtim këto pika, duke patur në konsideratë edhe publikimin e preventivit të munguar, i cili shkakton konfuzion për OE. Llogaritja e numrit të punonjësve bëhet mbi bazën e zërave të preventivit dhe manualit përkatës bashkë me analizat e çmimeve për zërat që nuk janë në manual”, duke mos pranuar këtë pretendim të ankimuesit.

III.7.4. Në nenit 77, pika 1, 2 dhe 4 “*Kërkesat për kualifikim*” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.7.5. Ndërsa në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.7.4. Për sa i përket pretendimit të ankimesit lidhur me kërkesën që ofertuesi të ketë drejtues teknik 1 (një) inxhinier të profilit strukturist dhe në stafin ndihmës ose mbështetës 1 (një) inxhinier elektrik që përmbush kriteret për të qenë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, 1 (një) inxhinier pjesë e stafit të shoqërisë, i cili të jenë të pajisur me certifikatën e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” dhe certifikatën “Përgjegjës për sigurinë”, 1 (një) specialist të certifikuar për “Punime në lartësi”, 1

(një) person të certifikuar “Specialist dhe përgjegjës për sigurimin teknik, shëndetin dhe mbrojtjen në punë” dhe 1 (një) person të certifikuar “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se kjo kërkesë për kualifikim është argumentuar nga ana e autoritetit kontraktor mbështetur në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, por këto dispozita ligjore i referohen kualifikimeve të operatorit ekonomik ofertues lidhur me kapacitetet njerëzore që ka në dispozicion lidhur me numrin e fuqisë punëtorë dhe jo kualifikimeve të stafit dhe për më tepër nuk është e argumentuar nga ana teknike lidhur me nevojën që ka autoriteti kontraktor që ofertuesi të ketë në stafin e tij personel të certifikuar me certifikatat e përcaktuara më sipër.

Gjithashtu, Komisioni konstaton, se kërkesa që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij personel të certifikuar për **punime në lartësi** dhe një **inxhinier strukturist** nuk është në përputhje me projektin dhe natyrën e punimeve të përcaktuara në zërat e preventivit, pasi nga shqyrtimi i këtij dokumenti (preventivi) nuk konstatohet që ka zëra punimësh të cilat do të kryhen në lartësi, si dhe nuk ka zëra punimesh për të cilat kërkohet prezenca e inxhinierit të ndërtimit të profilit strukturist.

Për më tepër, Komisioni konstaton, se kërkesa që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij personel të certifikuar si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” por me kushtin që ky person të jetë i diplomuar vetëm në profesionin e inxhinierit elektrik, është një kriter i paargumentuar dhe jo në përputhje me kushtet që parashikon legjislacioni shqiptar për të përfituar këtë lloj certifikimi.

Ndërsa lidhur me kërkesën kualifikuese në të cilën është përcaktuar se operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij një person që është i certifikuar si “*Specialist dhe përgjegjës për sigurimin teknik, shëndetin dhe mbrojtjen në punë*”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se kjo kërkesë për kualifikim është konfuze, pasi ky person njëkohësisht duhet të jetë edhe specialist i pajisur me certifikatën e “sigurimit teknik, shëndetin dhe mbrojtjen në punë” edhe përgjegjës i pajisur me certifikatën e “sigurimit teknik, shëndetin dhe mbrojtjen në punë”, duke sjellë konfuzion tek ofertuesit lidhur me përmbushjen e këtij kriteri dhe për më tepër duke mos përshkruar drejt titullin e certifikatës që duhet të ketë ky person, si dhe organizmin përkatës që e lëshon atë.

Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij 1 (një) drejtues teknik të profilit strukturist, 1 (një) inxhinier elektrik që përmbush kriteret për të qenë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, 1 (një) inxhinier pjesë e stafit të shoqërisë, i cili të jenë të pajisur me certifikatën e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” dhe certifikatën “Përgjegjës për sigurinë”, 1 (një) specialist të certifikuar për “Punime në lartësi”, 1 (një) person të certifikuar “Specialist dhe përgjegjës për sigurimin teknik, shëndetin dhe mbrojtjen në punë” dhe 1 (një) person të certifikuar “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” nuk është e argumentuar dhe në përputhje me objektin e prokurimit, prandaj autoriteti kontraktor me rishpalljen e kësaj procedure prokurimi duhet që të argumentojë nga ana teknike vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si dhe duhet që të heqë përcaktimin lidhur me pasjen nga

ana e operatorëve ekonomikë ofertues të 1 (një) drejtuesi teknik të profilit strukturist, duhet të heqë përcaktimin lidhur me arsimimin që duhet të kenë anëtarët e stafit mbështetës të cilët janë të pajisur me certifikatën “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, duhet të heqë kërkesën që një nga pjestarët e stafit të jetë i pajisur me certifikatën për punime në lartësi, si dhe autoriteti kontraktor duhet që të përcaktojë saktë kërkesën lidhur me detyrimin e operatorëve ekonomikë ofertues që të kenë në stafin e tyre një specialist i cili duhet të jetë i pajisur ose me certifikatën e “specialist i sigurimit teknik, shëndetin dhe mbrojtjen në punë” ose me certifikatën e “përgjegjës i sigurimit teknik, shëndetin dhe mbrojtjen në punë”, duke përcaktuar qartë titullin e certifikatës dhe organin kompetent që i lëshon këto certifikata.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “LA PORTA DELLA LUCE” ShPK ku kërkon: “Së dhjeti, në kundërshtim me udhëzimet e APP, keni kërkuar mjekun, ku në rastin e bashkimit të shoqërive keni kërkuar që të jetë nga të gjithë anëtarët, kërkesë kjo antiligjore dhe në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu, AK e kërkon mjekun për vitet 2019, 2020, 2021, por harron se e hap tenderin në muajin Qershor 2022.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.8.1. Në Shtojcën 7 “**FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” pika 2.3.6 “**Kapaciteti Teknik**” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë:

“6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) mjek ndërmarrje, kjo të vërtetohet me paraqitjen e Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratë pune e mjekut me operatorin ekonomik e cila duhet të jetë detyrimisht noteriale dhe e vlefshme për periudhën e ndërtimit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë një mjek ndërmarrje. Mjeku duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë të paktën për 3 vitet e fundit 2019, 2020, 2021..”

III.8.2. Në procesverbalin e datës 16.05.2022 “**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**” të publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues si më poshtë:

“Argumentimi: Ky kriter është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ku citon se fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

III.8.3. Lidhur me këtë pretendim të ankimuesit autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1201/2 prot, datë 23.05.2022 është shprehur se: *“Së shtati: Në vazhdim OE ankimues citon pretendimet e tij në lidhje me stafin teknik (konkretisht nga pika shtatë e ankimimit deri në pikën e njëmbëdhjetë) të nevojshëm për këtë procedurë prokurimi.*

- Autoriteti kontraktor do të marrë në shqyrtim këto pika, duke patur në konsideratë edhe publikimin e preventivit të munguar, i cili shkakton konfuzion për OE. Llogaritja e numrit të punonjësve bëhet mbi bazën e zërave të preventivit dhe manualit përkatës bashkë me analizat e çmimeve për zërat që nuk janë në manual”, duke mos pranuar këtë pretendim të ankimuesit.

III.8.4. Në nenit 77, pika 1, 2 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.8.5. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.8.6. Në Vendimin Nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, Kapitulli II “Klasifikimi i punëdhënësve në grupe, për efekt të organizimit të punëmarrësve në shërbimet për mbrojtjen dhe parandalimin”, përcaktohet se:

“1. Për efekt të organizimit të shërbimit të brendshëm për mbrojtjen dhe parandalimin, punëdhënësit janë klasifikuar në katër grupe, si më poshtë vijon:

1.1 Grupi A përfshin punëdhënësit me më shumë se 1000 (një mijë) punëmarrës. Ky numër punëmarrësish reduktohet në:

1.1.1 500 (pesëqind) punëmarrës për ndërmarrjet e:

11

a) industrisë së pastrimit dhe shpërndarjes së ujit;

b) industrisë së transformimit të metaleve, mekanikës e precizionit dhe industrisë optike, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industritë e referuara në nëndarjen

1.1.2, shkronjat “dh”, “e”, “ë” e “f”;

c) industritë e tjera prodhuese, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industritë referuara në pikën 1.1.2, shkronja “g”.

1.1.2 250 (dyqind e pesëdhjetë) punëmarrës për ndërmarrjet e:

a) industrisë së prodhimit e të shpërndarjes së energjisë elektrike, gazit, avullit dhe ujit të ngrohtë;

b) industrisë së prodhimit dhe të përpunimit fillestar të metaleve;

c) prodhimit industrial prej guri, çimentos, betonit, qeramikës, qelqit dhe të tjerët;

ç) industrisë kimike, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industritë e referuara në 1.1.3, shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”;

d) prodhimit industrial të fibrave artificiale dhe sintetike;

- dh) industrisë së fabrikimit të veprave në metale;
- e) industrisë së ndërtimit të makinerive dhe të pajisjeve mekanike;
- ë) industrisë së ndërtimit dhe të autopjesëve;
- f) industrisë së ndërtimit të pajisjeve të tjera të transportit;
- g) industrisë së drurit dhe mobilieve të drurit;
- gj) industrisë së ndërtimit dhe të punëve publike.

1.1.3. 50 (pesëdhjetë) punëmarrës për ndërmarrjet:

- a) e industrisë bërthamore;
- b) me furrat koks;
- c) e përpunimit të naftës;

12

- ç) e industrisë së prodhimit të kimikateve bazë;
- d) e industrisë petro-kimike dhe karbokimike;

655

dh) e industrisë së prodhimit të produkteve të tjera kimike, kryesisht për industri dhe bujqësi.

1.2 Grupi B përfshin punëdhënësit me punëmarrës:

- a) nga 251 deri në 1000 persona, të cilët nuk janë përfshirë në grupin A;
- b) nga 100 deri në 250 persona, të cilët nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.1 të këtij kreu;
- c) nga 50 deri në 200 persona, që nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.2 të këtij kreu;
- ç) nga 20 deri në 50 persona, që nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.3 të këtij kreu.

1.3 Grupi C përfshin punëdhënësit me më pak se 200 (dyqind) punëmarrës, të cilët nuk përfshihen në grupet A dhe B.

1.4 Grupi D përfshin punëdhënësit që punësojnë më pak se 20 (njëzet) punëmarrës”.

III.8.7. Ndërsa në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” pika 1, pika 3, gërma” b “ dhe pika 4 gërma “b” është përcaktuar:

“1. "Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje, si më poshtë vijon: “6. Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.”. [...]

3. Në kreun IV, pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon: “7. Personi përgjegjës, i ngarkuar nga shërbimi i specializuar jashtë ndërmarrjes për menaxhimin e riskut, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

b) në lidhje me shëndetin në punë të ketë formim profesional në fushën e mjekësisë së përgjithshme dhe i cili:

b.1 të jetë kualifikuar si mjek i sëmundjeve profesionale/mjek pune;

b.2 të jetë i licencuar nga Urdhri i Mjekut për ushtrimin e profesionit”.

4/b) Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit një vit pas hyrjes në fuqi”.

III.8.8. Në Vendimin Nr. 639, datë 7.9.2016 “Për përcaktimin e rregullave, të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”, pika 1, gërma “ë”, përcaktohet se:

“Mjeku i punës/sëmundjeve profesionale”, çdo mjek që gëzon të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë, i cili ka një formim afatshkurtër ose afatgjatë në fushën e mjekësisë së punës/sëmundjeve profesionale, të ofruar nga institucionet publike ose private të licencuara në Republikën e Shqipërisë ose në institucione jashtë vendit të njohura nga strukturat përkatëse në Republikën e Shqipërisë.”.

III.8.9. Për sa i përket pretendimit të ankimuesit lidhur me kërkesën që ofertuesi të ketë drejtues teknik 1 (një) mjek në ndërmarrje, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se kjo kërkesë për kualifikim është argumentuar nga ana e autoritetit kontraktor mbështetur në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, por këto dispozita ligjore i referohen kualifikimeve të operatorit ekonomik ofertues lidhur me kapacitetet njerëzore që ka në dispozicion lidhur me numrin e fuqisë punëtorë dhe jo kualifikimeve të stafit dhe për më tepër nuk është e argumentuar nga ana teknike lidhur me nevojën që ka autoriteti kontraktor që ofertuesi të ketë në stafin e tij 1 (një) mjek.

KPP konstaton, se autoriteti kontraktor duhej t’u referohej dispozitave ligjore në fuqi në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër. Në kushtet kur për të realizuar punimet objekt-prokurimi kërkohet një numër prej rreth 45 (dyzet e pesë) punonjësish, pra një numër më i vogël se ai përcaktuar në bazën ligjore të sipërpërmendur, atëherë kërkesa që

operatori ekonomik ofertues të disponojë një mjek në stafin e tij nuk është në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur.

Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij 1 (një) mjek nuk është e argumentuar dhe nuk është e mbështetur në dispozitat ligjore të sipërpërmendura, prandaj autoriteti kontraktor me rishpalljen e kësaj procedure prokurimi duhet që të heqë kërkesën që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij 1 (një) mjek.

Për sa më sipër pretendimi i ankimesit qëndron.

III.8.4.2. Për sa i përket pretendimit të ankimesit lidhur me kërkesën që në rastin kur ofertuesi paraqet ofertë si bashkim operatorësh ekonomik dhe secili prej anëtarëve të bashkimit të shoqërive duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) mjek, si dhe pretendimit lidhur me periudhën kohore për të cilën duhet që operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë 1 (një) mjek, nuk do të merren në shqyrtim nga Komisioni i Prokurimit Publik pasi kërkesa për disponimin e mjekut do të hiqet me rishpalljen e kësaj procedure prokurimi dhe nuk ka më objekt-ankimi.

III.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “LA PORTA DELLA LUCE” ShPK ku kërkon: “Së njëmbëdhjeti, AK kërkon 45 punonjës, ndërkohë që referuar grafikut të punimeve dhe zërave që janë parashikuar aty, turneve të punës, kryhet me vetëm 11 punonjës, ndërkohë që referuar makinerive dhe stafit të kërkuar do 180 punonjës.

Në këtë mënyrë, po e lëmë në dorë të KPP ta vlerësojë këtë kriter antiligjor, sepse AK nuk e ka argumentuar teknikisht përse duhen 45 punonjës.

Pra, kërkojmë nga KPP të analizojë teknikisht se me sa punonjës kryhet puna në këtë objekt.

Gjithashtu, AK kërkon si periudhë vitet 2019, 2020, 2021 sepse nuk ka rëndësi për AK që shoqëria ofertuese mund të mos ti ketë punonjësit në muajin janar 2022 e në vazhdim, pasi e rëndësishme për AK është që ti ketë patur në vitin 2019.

Ndërkohë që vetë kërkesat nuk përputhen me njëra tjetrën, ku vetë AK kërkon që vërtetimi për numrin e punonjësve të specifikohet numri i tyre për muajt e fundit, po përse e kërkon këtë, AK nuk di gjë. Pra, AK harron që vetë ka kërkuar vitet 2019, 2020, 2021, ndërkohë vetë kërkon edhe muajt e fundit po përse, nuk kuptohet. Këtë kriter evaziv ta sqarojë KPP.

Së dymbëdhjeti, kërkojen listpagesat e viteve 2019, 2020, 2021, por mbase AK ka harruar që tenderi hapet në muajin Qershor 2022.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.9.1. Në Shtojcën 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 2.3.7 “Kapaciteti Teknik” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë:

“7. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë fuqi minimale punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej mesatarisht 45 (dyzetë e pesë) persona të punësuar me kohë të plotë, për periudhën 3 (tre) vitet e fundit 2019, 2020, 2021.

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.

b) Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën tre vitet e fundit 2019, 2020, 2021.”.

III.9.2. Në procesverbalin e datës 16.05.2022 “**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**” të publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues si më poshtë:

“Argumentimi: Ky kriter është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ku citon se fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

III.9.3. Lidhur me këtë pretendim të ankimuesit autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1201/2 prot, datë 23.05.2022 është shprehur se: “Së shtati: Në vazhdim OE ankimues citon pretendimet e tij në lidhje me stafin teknik (konkretisht nga pika shtatë e ankimimit deri në pikën e njëmbëdhjetë) të nevojshëm për këtë procedurë prokurimi.

- Autoriteti kontraktor do të marrë në shqyrtim këto pika, duke patur në konsideratë edhe publikimin e preventivit të munguar, i cili shkakton konfuzion për OE. Llogaritja e numrit të punonjësve bëhet mbi bazën e zërave të preventivit dhe manualit përkatës bashkë me analizat e çmimeve për zërat që nuk janë në manual.

Së teti: Në lidhje me pretendimin e dymbëdhjetë të OE ankimues ku ankimohej kërkimi i listëpagesave për vitet 2019-2021:- Listëpagesat, në ripublikimin e procedurës do të përputhen me kohën në të cilën do të rizhillohet tenderi.”, duke mos pranuar këtë pretendim të ankimuesit.

III.9.4. Në nenit 77, pika 1, 2 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.9.5. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.9.6. Për sa i përket pretendimit të ankimuesit lidhur me kërkesën që operatori ekonomik ofertues të ketë të punësuar mesatarisht 45 (dyzetë e pesë) persona të punësuar me kohë të plotë, për periudhën 3 (tre) vitet e fundit 2019, 2020, 2021, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se kjo kërkesë për kualifikim është argumentuar nga ana e autoritetit kontraktor mbështetur në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, dispozita ligjore të cilat i referohen kualifikimeve të operatorit ekonomik ofertues lidhur me kapacitetet njerëzore që ka në dispozicion për sa i përket numri të fuqisë punëtore, por numri i punonjësve të kërkuar nuk është argumentuar nga ana teknike lidhur me përcaktimin e këtij numri mbështetur në grafikun e punimeve dhe volumin e zërave të preventivit.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se periudha për të cilën kërkohet që operatori ekonomik ofertues të ketë numër punonjësish të punësuar me kohë të plotë është një kërkesë që nuk krijon siguri lidhur me faktin nëse operatorët ekonomike i kanë kapacitetet teknike dhe profesionale për realizimin e kontratës, pasi është kërkuar që ofertuesit të kenë 45 (dyzet e pesë) punonjës për periudhën 3 (tre) vitet e fundit 2019, 2020, 2021 dhe të paraqesin listëpagesat për periudhën tre vitet e fundit 2019, 2020, 2021, ndërkohë që procedura e prokurimit zhvillohet më datë 06.06.2022 dhe për periudhën janar-maj 2022 nuk kërkohet asnjë dokument që të provojë se ofertuesit kanë të punësuar këtë numër punonjësish.

Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa kualifikuese e përcaktuar në pikën 2.3.7 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit nuk është e argumentuar teknikisht referuar grafikut të punimeve dhe volumit të zërave të preventivit, si dhe nuk krijon siguri tek autoriteti kontraktor lidhur me zotërimin nga ana e operatorëve ekonomik të kapaciteteve teknike lidhur me fuqinë punëtore në momentin e ofertimit, prandaj autoriteti kontraktor me rishpalljen e kësaj procedure prokurimi duhet që të modifikojë kriterin kualifikues lidhur me numrin e punonjësve duke e modifikuar atë në proporcion me grafikun e punimeve dhe volumin e zërave të punimeve të përcaktuar në preventiv, si dhe të përcaktojë periudhën për të cilën kërkohet që ofertuesit e mundshëm të kenë të fuqinë punëtore të kërkuar duke marrë parasysh afatin kohor të zhvillimit të kësaj procedure prokurimi

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.10. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “LA PORTA DELLA LUCE” ShPK ku kërkon: “Së trembëdhjeti, në kriteret specifike për kualifikim, AK ka kërkuar që shoqëria duhet të ketë të paktën 32 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik.

Tek procesverbali i argumentimit të kriterëve, rezulton se AK në kundërshtim me ligjin, nuk ka argumentuar përse duhen 32 të tillë.

Në këtë kriter, AK ka parashikuar një kriter evaziv, ku kërkon edhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik dhe certifikata trajnimi. Në këtë mënyrë, që ofertuesit të vihen në kushte të barabarta konkurrimi dhe vlerësimi, AK duhet të specifikojë se kush janë institucionet kompetente që lëshojnë këto certifikata të kërkuara.

Në këtë pikë, gjithashtu AK ka kërkuar:

- Ing. Ndërtimi/specialist për sigurimin teknik 1 (një);
- Teknikë ndërtimi 2 (dy);
- Hidraulikë 2 (dy);
- Shoferë/manovratorë 3 (tre);
- Saldatorë 1 (një);
- Muratorë 4 (katër);
- Suvatues/specialistë ndërtimi 1 (një);
- Bojaxhi 2 (dy);
- Hidroizolues 2 (dy);
- Pllakashtrues 2 (dy);
- Karpentierë 2 (dy);
- Hekurkthyes 1 (një);
- Elektriçistë 2 (dy);
- Mekanikë 2 (dy);
- Punime PVC gome 2 (dy);
- Manoviatorë mjete të rënda 2 (dy);

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë. Tani tek kjo pikë kërkohet vetëm IQT, kurse më sipër në të njëjtin kriter kërkohet edhe certifikata, lutemi ta ndajë mendjen AK se çfarë kërkon, sepse kërkesa bëhet evasive dhe nuk i vendos ofertuesit në kushte të barabarta konkurrimi dhe vlerësimi.

Pra, shuma totale e numrit të kërkuar në këtë pikë del 31, kurse AK parashikon se duhen 32 të tillë. Lind pyetja, po njëri çfarë duhet të jetë, apo mund të paraqitet edhe llamarinist apo infermier, s'ka problem për AK.

Sqarojmë AK se, inxhinier ndërtimi/specialist për sigurimin teknik, nuk janë i njëjti profesion. Pra, në kushtet kur në kriteret për kualifikim AK ka kërkuar ose njërin ose tjetrin, i bie që po të paraqitet vetëm njëri prej tyre, plotësohet kërkesa antiligjore e AK.

Lutemi nga AK të na sqarojë me bazë ligjore se ku është parashikuar që inxhinieri i ndërtimit është i barasvlershëm me specialistin për sigurimin teknik.

Gjithashtu, të kihet shumë kujdes tek ky kriter. KPP të bëjë verifikimet e duhura, sepse mbase njësia e prokurimit nuk e di fare se çfarë ka kërkuar.

Përse duhen dy teknikë ndërtimi, për një punë të tillë kaq të vogël, vetëm AK e di. Pra, AK të kërkon një inxhinier ndërtimi, një strukturist ku këta të dy duhet të jenë drejtues teknikë, kërkon një specialist për sigurinë ose inxhinier ndërtimi dhe dy teknikë ndërtimi, hajde kërkesa për kualifikim hajde.

Në këto kushte, AK të na sqarojë dhe argumentojë teknikisht dhe ligjërisht përse kërkon 5 të tillë, apo duhet nga një inxhinier çdo 2 metër larg njëri tjetrit.

A mund të na sqarojë titullari i AK dhe KPP se çfarë pune do të kryejë në këtë objekt hidrauliku, bojaxhiu, hidroizoluesi, pllakashtruesi, ai i gomës PVC, hekurkthyesi, etj, ndërkohë që tek zërat në grafikun e realizimit të punimeve, nuk keni asnjë zë të tillë?

Së katërmbëdhjeti, në kërkesat për kualifikim AK ka kërkuar që,

• Për specialistët operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratat individuale të punës, diplomë dhe/ose kualifikimin përkatës për secilin punonjës. Dëshmia e kualifikimit dhe/ose diploma të jetë e lëshuar nga institucione të licencuara shtetërore Arsimore Profesionale Shtetërore. Secili specialist i sipërcituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë.

Ak që ti vendosi ofertuesit në kushte të barabarta konkurrimi dhe vlerësimi, duhet të specifikojë dhe sqarojë se kush janë specialistët e kërkuar, sepse inxhinieri i ndërtimit është Inxhinier Gjithashtu, a e di AK se, kërkon specialist dhe për specialistët nuk janë me shkollë të lartë dhe nuk disponojnë dot ligjërisht diploma, atëherë të sqarohet se kush janë diplomat e specialistëve dhe kush fakultet apo universitet i lëshon ato.

• Operatori ekonomik duhet të paraqesë Dëshmi të aftësisë profesionale, certifikatë të aftësisë Profesionale dhe leje drejtimi për punonjësit që do të përdorin makineritë e rënda sipas mjeteve të kërkuara që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, shoqëruar me kontratën e punës. Të gjithë punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në listpagesa të paktën për 6 muajt e fundit. Përkatësisht OE duhet të ketë në përbërje të stafit:

1 (një) manovrator me DAP Automakinist, Leje drejtimi, certifikatë Aftësimi Profesional.

1 (një) manovrator me DAP Eskavatorist dhe Leje drejtimi.

AK ka harruar se më sipër ka kërkuar manovratorë 5 të tillë, ndërkohë që shton edhe dy të tjerë, pra 7, duke hartuar një kriter evaziv, diskriminues, i cili ka vetëm një qëllim, uljen e konkurrencës në prokurim.

Atëherë KPP të sqarojë kërkesën edhe për 7 manovratorë dhe çfarë mjeti të kërkuar do t'i japin ata?”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.10.1. Në Shtojcën 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 2.3.8 “Kapaciteti Teknik” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë:

“8. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar për tre vitet e fundit të paktën 32 (tridhjetë e dy) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme), lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe punonjës me Certifikata Trajnimi sipas profesioneve nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve:

- Ing. Ndërtimi/specialist për sigurimin teknik 1 (një);
- Teknikë ndërtimi 2 (dy);
- Hidraulikë 2 (dy);
- Shoferë/manovratorë 3 (tre);
- Saldatorë 1 (një);
- Muratorë 4 (katër);
- Suvatues/specialistë ndërtimi 1 (një);
- Bojaxhi 2 (dy);
- Hidroizolues 2 (dy);

- Pllakashtrues 2 (dy);
- Karpentierë 2 (dy);
- Hekurkthyes 1 (një);
- Elektracistë 2 (dy);
- Mekanikë 2 (dy);
- Punime PVC gome 2 (dy);
- Manovratorë mjete të rënda 2 (dy);

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- *Për specialistët operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratat individuale të punës, diplomë dhe ose kualifikimin përkatës për secilin punonjës. Dëshmia e kualifikimit dhe/ose diploma të jetë e lëshuar nga institucione të licencuara shtetërore Arsimore Profesionale Shtetërore. Secili specialist i sipërcituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Dëshmi të aftësisë profesionale, certifikatë të aftësisë Profesionale dhe leje drejtimi për punonjësit që do të përdorin makineritë e rënda sipas mjeteve të kërkuara që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, shoqëruar me kontratën e punës. Të gjithë punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në listpagesa të paktën për 6 muajt e fundit. Përkatësisht OE duhet të ketë në përbërje të stafit:*
 - 1 (një) manovrator me DAP Automaknistë, Leje drejtimi, certifikatë Aftësimi Profesional.
 - 1 (një) manovrator me DAP Ekskavatorist dhe Leje drejtimi.”.

III.10.2. Në procesverbalin e datës 16.05.2022 “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues si më poshtë:

“Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, mjedisi, hidroteknik, topograf, etj. është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij”.

III.10.3. Lidhur me këtë pretendim të ankimuesit autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1201/2 prot, datë 23.05.2022 është shprehur se: “Së nënti: Në pretendimin e trembëdhjetë të OE ankimues në lidhje me kriteret specifike për kualifikim ku nga AK janë kërkuar 32 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik.

- Në mënyrë që ofertuesit të vihen në kushte të barabarta ofertimi, do të shqyrtohet kjo pikë nga AK në përputhje me zërat e preventivit të munguar, duke sqaruar edhe nevojën e stafit teknik të kualifikuar.

Së dhjeti: Sa i takon pretendimit të katërbëdhjetë të ankimuesit në lidhje me diplomën dhe kualifikimin përkatës dhe numrit të manovratorëve.

- AK ka kërkuar diplomën dhe kualifikimin përkatës. Pra për inxhinierët duhet diploma, për specialistët kualifikimi që kanë. Saktësimi i numrit të manovratorëve do të merret parasysht nga AK”, duke pranuar pjesërisht këtë pretendim të ankimuesit.

III.10.4. Në nenit 77, pika 1, 2 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.10.5. Ndërsa në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.10.4.1. Për sa i përket pretendimit të ankimesit lidhur me kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 të Shtojës 7 të dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se kjo kërkesë për kualifikim është argumentuar nga ana e autoritetit kontraktor mbështetur në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, por këto dispozita ligjore i referohen kualifikimeve të operatorit ekonomik ofertues lidhur me kapacitetet njerëzore që ka në dispozicion për sa i përket numrit të fuqisë punëtore dhe jo kualifikimeve të stafit dhe për më tepër nuk është e argumentuar nga ana teknike lidhur me nevojën që ka autoriteti kontraktor që ofertuesi të ketë në stafin e tij personel të specializuar sipas

profesioneve të përcaktuara në këtë kriter dhe të cilët janë të nevojshëm për kryerjen e zërave të punimeve sipas preventivit.

Gjithashtu, Komisioni konstaton, se në këtë kriter kualifikues autoriteti kontraktor kërkon që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij 32 (tridhjetë e dy) punonjës të kualifikuar ndërkohë që sipas profesioneve të përcaktuara në këtë kriter kërkon 31 (tridhjetë e një) punonjës të kualifikuar çka sjell konfuzion tek operatorët ekonomik lidhur me përmbushjen e këtij kriteri.

Ndërkohë Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për autoritetin kontraktor nga njëra anë kërkon që operatorët ekonomik ofertues të dëshmojnë se e disponojnë këtë personel të kualifikuar nëpërmjet paraqitjes së dëshmimeve të kualifikimit të lëshuar nga IQT, ndërsa nga ana tjetër në po të njëjtin kriter kualifikues kërkon që operatorët ekonomik ofertues të dëshmojnë se e disponojnë këtë personel të kualifikuar nëpërmjet paraqitjes së dëshmisë së kualifikimit dhe/ose diploma të cilat të jenë të lëshuara nga institucione të licencuara shtetërore Arsimore Profesionale Shtetërore, çka sjell konfuzion tek operatorët ekonomik lidhur me përmbushjen e këtij kriteri.

Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa kualifikuese e përcaktuar në pikën 2.3.8 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit nuk është e argumentuar teknikisht referuar natyrës së punimeve referuar zërave të preventivit, për kryerjen e të cilave kërkohen që operatorët ekonomik ofertues duhet të kenë personel të kualifikuar, si dhe ky kriter nga mënyra se si është formuluar sjell konfuzion tek operatorët ekonomikë lidhur me dokumentacionin që duhet të paraqesin për të vërtetuar disponimin e personelit të kualifikuar, prandaj me rishpalljen e kësaj procedure prokurimi autoriteti kontraktor duhet ta modifikojë kriterin kualifikues duke hequr kërkesën që operatorët ekonomikë të kenë në stafin e tyre të punësuar punonjës me profesionet inxhinier ndërtimi ose specialist për sigurimin teknik, hidraulik, bojaxhi, hidroizolues, pllakashtrues, Punime PVC gome dhe hekurthyes, të modifikojë kërkesën për disponimin 2 (dy) teknikë ndërtimi duke kërkuar 1 (një) teknik ndërtimi, si dhe të vendosë numrin e përgjithshëm të personelit të kualifikuar në proporcion me shumatoren e profesioneve që do të kërkoje dhe për më tepër të përcaktojë saktë dëshminë konkrete që duhet paraqesin operatorët ekonomikë ofertues për të vërtetuar që personeli i tyre ka formimin profesional të kërkuar, duke përcaktuar njëkohësisht dhe organet kompetente që i lëshojnë këto dëshmi.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, lidhur me pretendimin e ankimuesit për profesionet e tjera të përcaktuara në këtë kriter kualifikues gjykon, se autoriteti kontraktor në rishpalljen e kësaj procedure prokurimi duhet që të argumentojë teknikisht dhe në përputhje me llojin e punimeve të shprehura në zërat e preventivit, nevojën që ka autoriteti kontraktor që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij punonjës të kualifikuar sipas profesioneve të cilat autoriteti kontraktor do t'i gjykojë si të nevojshme për kryerjen e punimeve.

Për sa më sipër pretendimi ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.10.4.2. Për sa i përket pretendimit të ankimuesit lidhur me kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit ku shprehet se: *“AK ka harruar se më sipër ka kërkuar manovratorë 5 të tillë, ndërkohë që shton edhe dy të tjerë, pra 7, duke hartuar*

një kriter evaziv, diskriminues, i cili ka vetëm një qëllim, uljen e konkurrencës në prokurim. Atëherë KPP të sqarojë kërkesën edhe për 7 manovratorë dhe çfarë meti të kërkuar do ti japin ata?”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues ka pranuar këtë pretendim të ankimuesit dhe me rishpalljen e kësaj procedure prokurimi do të bëjë rishikimin e këtij kriteri, duke përcaktuar saktë numrin e manovratorëve, prandaj ky pretendim i ankimuesit nuk do të merret në shqyrtim, pasi nuk ka më objekt-ankese.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk merret në shqyrtim.

III.11. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “LA PORTA DELLA LUCE” ShPK ku kërkon: **Së pesëmbëdhjeti**, lidhur me makineritë dhe pajisjet e kërkuara, mundohemi të bëjmë lidhjen e tyre me zërat që ju keni parashikuar tek grafiku i punimeve, por nuk po bëjmë dot lidhjen se çfarë pune do të kryejnë.

I keni kërkuar mjetet në pronësi ose me qira, por nuk e kuptojmë këtë fjalën e dytë se çfarë është. Keni kërkuar kamion vetëshkarkues 10-20 ton, 2 copë, por duam të na sqaroni, a lejohen me ligj të hyjnë këto mjete të tonazhit kaq të madh? Apo mos vallë do të bëni ndonjë rrugë në ndonjë vend tjetër dhe jo tek Liqeni Artificial?

Sipas projektit që AK ka publikuar në këtë procedurë prokurimi, rruga ka një gjerësi prej rreth 1.5m, ndërkohë që mjetet e këtyre tonazheve janë shumë herë më të gjera se pjesa e rrugës që ju po pretendoni se doni të bëni, atëherë lind pyetja: Mos keni harruar të kërkonit edhe krahë që të fluturojnë nga lart, se nga rruga nuk hyjnë dot mjetet 20 Tonëshe. Atëherë pse e keni kërkuar? Le ta shpjegojë njësia e prokurimit se ata do të jenë edhe personal përgjegjës që do të përgjigjen ligjërisht për këto shkelje të qëllimshme dhe të rënda ligjore.

Keni kërkuar kamion me vinç, por referuar zërave të grafikut të punimeve, na sqaroni se çfarë materialesh do të shkarkojë vinçi i kamionit, ndërkohë që vet kamioni referuar projektit tuaj nuk hyn dot në këtë rrugë rreth 1.5m të gjerë?

Po autoboti i ujit nga do hyjë dhe çfarë pune do të realizojë, sepse keni kërkuar edhe depozita uji. Me autobot mos vallë do bëni larjen e rrugës?

Po rimorkiatori nga do hyjë në këtë rrugë rreth 1.5m të gjerë, dhe çfarë do transportojë? Po matrapiku çfarë do të thyejë apo prishi? Apo ta keni një herë, se ska gjë.

Po me 2 copë elektrobandë çfarë zëri do realizoni?

Po 2 kontejnerë për çka i doni, apo duhet të ketë zyra të mëdha tek ky objekt, sepse është shumë i fuqishëm dhe rëndësishëm. Mirë një kontejner hajde e kuptojmë se e doni për zyra, po kontejnerin tjetër ca do e bëni? Apo do mbani veglat e punës.

Po kur keni llogaritur që duhen edhe 3 copë gjeneratorë, a e keni llogaritur edhe konsumin e naftës, atëherë kur kërkohe tre të tillë përse afati kërkohe 6 muaj dhe jo 21 ditë?

Lutemi na sqaroni se çfarë do të realizoni me kompresorin e ajrit?

Po a e dini se çfarë është vinçi karel, ku do ta mbështetni, ku do e vendosni, çfarë do të ngrejë?

Po me saldatrice çka do bëni, çka do realizoni?

Po 1000 m2 armatura druri, çka do bëni, ndonjë pallat?

Po skeleri betoni dhe suvatimi, për cilin pallat i keni kërkuar, sepse po tenderoni rrugë?

Po rripat e sigurimit për punime në lartësi për ça i doni, apo do ju duhen për ndonjë pallat, sepse po tenderoni rrugë?

Keni kërkuar edhe prozhektorë për ndriçim për natën, atëherë kërkojmë të argumentohet se si është përlogaritur fondi limit në kushtet kur do të punohet me tre tume?”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.11.1. Në Shtojcën 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” pika 2.3.9 “*Kapaciteti Teknik*” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë:

“9. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formulimit përmbledhës të vetëdeklarimit):

Nr	MJETET	Gjendja	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues 10 - 20 ton	Pronësi ose me qira	2 copë
2	Kamion me vinç	Pronësi ose me qira	1 copë
3	Kamionçinë	Pronësi ose me qira	1 copë
4	MT – Fiat - JCB	Pronësi ose me qira	1 copë
5	Betoniere	Pronësi ose me qira	3 copë
6	Vibrator betoni	Pronësi ose me qira	3 copë
7	Eskavator me zinxhirë	Pronësi ose me qira	2 copë
8	Depozitë uji 5000 litra	Pronësi ose me qira	3 copë
9	Autobot uji	Pronësi ose me qira	1 copë
10	Rrul	Pronësi ose me qira	2 copë
11	Rimorkiator	Pronësi ose me qira	1 copë
12	Asfaltoshtruese	Pronësi ose me qira	1 copë
13	Grejder nivelues	Pronësi ose me qira	1 copë
14	Matrapik	Pronësi ose me qira	3 copë
15	Elektrobandë	Pronësi ose me qira	2 copë

16	Kontejner për zyra kantieri	Pronësi ose me qira	2 copë
17	Gjenerator	Pronësi ose me qira	3 copë
18	Mini eskavator	Pronësi ose me qira	1 copë
12	Bobcat	Pronësi ose me qira	1 copë
13	Kompresor ajri	Pronësi ose me qira	1 copë
14	Vinç karel	Pronësi ose me qira	2 copë
15	Makineri ngjeshës nivelim shtresash	Pronësi ose me qira	1 copë
16	Saldatriçe	Pronësi ose me qira	2 copë
17	Armatura druri	Pronësi ose me qira	1000 m2
18	Skeleri betoni dhe suvatimi	Pronësi ose me qira	2000 m2

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 45 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 10 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Uniforma/ Jelekë pune 45 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; certifikatë e kontrollit teknik; siguracion mjete (i vlefshëm); certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme);
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës; dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë); leje qarkullimi; certifikatë e kontrollit teknik; siguracion mjete (i vlefshëm); certifikatë për transport mallrash (e vlefshme);
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit

- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas Deklaratës së Shoqërisë ofertuese*
- f) *Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruara nga operatori ekonomik si më sipër, ose ti kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ”.*

III.10.2. Në procesverbalin e datës 16.05.2022 “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues si më poshtë:

“Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Njëpërmjet këtyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara njëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentet e Tenderit).*

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm të vërtetojë se zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.”.

III.11.3. Lidhur me këtë pretendim të ankimuesit autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1201/2 prot, datë 23.05.2022 është shprehur se: “Së njëmbëdhjeti: Sa i takon pretendimit të pesëmbëdhjetë të OE ankimues, në lidhje me makineritë dhe pajisjet e kërkuara, nevojës për saktësim në lidhje me pronësinë e tyre, mënyrën e aksesimit në Park, etj :

- AK, do të jetë transparent në momentin e publikimit të preventivit, i cili do të qartësojë edhe lidhjen ndërmjet mjeteve që kërkohen me zërat e punimeve të preventivuara. Mjetet janë kërkuar

ose me qira ose në pronësi në mënyrë që të mos ketë diskriminim. Për t'ju qartësuar, objekti i prokuruar do të ndërtohet në hyrje të Liqenit Artificial, nga ana veriore pranë Fakultetit Gjeologji dhe Miniera, dhe nuk ka akses në brendësi të PMLAT. Rruga do ketë një gjerësi prej 3.5 m”, duke mos pranuar këtë pretendim të ankimuesit.

III.11.4. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “*LA PORTA DELLA LUCE*” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për këtë pretendim të ngritur në formën e sqarimit, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit me shkresën nr. 1201/2 prot, datë 23.05.2022 nuk ka dhënë sqarime të hollësishme lidhur me këtë konstatim të operatorit ekonomik ankimues, prandaj duhet të sqarojë ankimuesin në mënyrë shteruese se përse nevojitet që operatorit ekonomik ofertues duhet të disponojë 2 copë kamion vetëshkarkues 10-20 ton, kamion me vinç, rimorkiator, 2 copë elektrobandë, 2 kontejnerë 3 copë gjeneratorë, kompresorin e ajrit, saldatriçe, 1000 m2 armatura druri, skeleri betoni dhe suvatimi, rripat e sigurimit për punime në lartësi dhe prozhektorë për ndriçimi për natën dhe se sa e nevojshme është disponimi i këtyre mjeteve për realizimin e zërave të preventivit në përputhje me volumin e tyre dhe grafikun e realizimit të tyre, që të shmangët çdolloj konfuzioni në radhët e operatorëve ekonomikë lidhur me hartimin e ofertës teknike dhe ekonomike dhe njëherazi për lehtësinë e punës së KVO në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Akoma më tej KPP gjykon, se sqarimi në rastin konkret është i nevojshëm edhe në funksion të trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe ngarkimin e tyre me të njëjtat të drejta dhe detyrime, duke shmangur kështu trajtimin diskriminues ndërmjet tyre, në kushtet kur mund të ndodhë që operatorë të ndryshëm të paraqesin oferta teknike dhe ekonomike jo në përputhje me kriteret teknike. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në sqarimin që do i japë ankimuesit duhet të përcaktojë qartë dhe saktë se përse është i nevojshëm disponimi i këtyre mjeteve për realizimin e punimeve të parashikuara në zërat e preventivit në proporcion me natyrën e punimeve të këtyre zërave dhe volumin e tyre dhe njëherazi të bëjë publikimin e sqarimit përkatës në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me nenin 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. me rishpalljen e kësaj procedure prokurimi

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor kur të rishpalli këtë procedurë prokurimi duhet që të argumentojë këtë kriter kualifikues në përputhje me volumin dhe natyrën e zërave të punimeve të shprehura në preventiv, duke përcaktuar qartë vetëm mjetet dhe pajisjet që janë të nevojshme për kryerjen e punimeve

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.12. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “*LA PORTA DELLA LUCE*” SHPK ku kërkon: “*Së shtatëmbëdhjeti, AK ka kërkuar edhe ISO 99:2012, 27001:2013, 50001:2011, 20000:2018, 3834:2006, të cilat nuk kanë asnjë lidhje teknike me objektin konkret të prokurimit. Lutemi na sqaroni se çfarë do të saldoni, ku e keni sigurinë e informacionit etj.*

Gjithashtu, kërkesa që në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili duhet ti disponojë këto ISO, është një kërkesë antiligjore.

Së tetëmbëdhjeti, AK ka kërkuar: Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të vendimit Nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave, “ Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

I themi AK që ka ngelur akoma përpara dy vjetësh që VKM nr. 914 nuk ekziston, pra sqaroni se ku e keni gjetur këtë kërkesë për kualifikim copy paste dhe Çfarë grafiku kërkonti kur ju vetë keni shkelur ligjin dhe nuk dini se sa është afati i grafikut të realizimit të punimeve, sepse nuk ju përputhet me punonjësit e kërkuar, me makineritë e kërkuara dhe me zërat që keni dhënë në këtë grafik punimesh.

Së nëntëmbëdhjeti, keni kërkuar edhe planorganizimin dhe planin e sigurisë në kantier për punimet, po lutemi na sqaroni se si duhet ta bëjmë planorganizimin me mjete e kërkuara si kamion 20 tonsh, saldatrice, hidraulikun, etj, kur ndërkohë ju s'keni asnjë zë për punime të tilla.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.12.1. Në Shtojcën 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 2.3.10 “Kapaciteti Teknik” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë:

“10. Operatori/ët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë:

- Certifikimi i sistemit për menaxhimin e cilësisë ISO 9001 – 2008
- Certifikimi i sistemit për menaxhimin mjedisor ISO 14001 - 2004
- Certifikimi i sistemit për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë OHSAS – 45001 - 2018
- Certifikimi i sistemit për menaxhimin e integruar PAS 99 : 2012
- Certifikimi i sistemit për menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor ISO 39001 : 2012
- Certifikimi i sistemit për menaxhimin e sigurisë së informacionit ISO 27001 - 2013
- Certifikimi i sistemit për menaxhimin e energjisë ISO 50001 - 2011
- Certifikimi i sistemit për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë informative ISO/IEC 20000 – 1:2018
- Certifikimi i sistemit për menaxhimin për kushtet e cilësisë për shkrirjen e metaleve EN ISO 3834 – 2:2006

Në rastin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive secili operator duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme, në varësi të punimeve që do të marri përsipër konform marrëveshjes. Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të vendimit Nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave, “ Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Çdo ofertues duhet të paraqesë Planorganizimin dhe Planin e Sigurisë në Kantier për punimet në objekt sipas VKM nr. 692 datë 13.12.2001 “ Për masat e veçanta të sigurimit dhe të ruajtjes së shëndetit në punë” i ndryshuar.

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose ti kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik””.

III.12.2. Në procesverbalin e datës 16.05.2022 “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues si më poshtë:

“Argumentim: *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të vendimit Nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave, “ Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Çdo ofertues duhet të paraqesë Planorganizimin dhe Planin e Sigurisë në Kantier për punimet në objekt sipas VKM nr. 692 datë 13.12.2001 “ Për masat e veçanta të sigurimit dhe të ruajtjes së shëndetit në punë” i ndryshuar.

Argumentim: *Kriter i vendosur në referencë të punimeve dhe specifikimeve teknike”.*

III.12.3. Lidhur me këtë pretendim të ankimuesit autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1201/2 prot, datë 23.05.2022 është shprehur se: “**Së dymbëdhjeti:** Operatori ekonomik ankimues ka kërkuar shpjegim në lidhje me certifikimin ISO dhe disponimin e tyre nga secili OE në rast bashkimi operatorësh.

- Sa i takon certifikimit të operatorëve, kjo kërkesë do të shqyrtohet nga ana e autoritetit kontraktor duke u marrë parasysh në përputhje me zërat e preventivuar sipas preventivit që do të publikohet në ripublikimin e kësaj procedure. Në varësi të ndarjes së zërave për secilin OE të bashkimit të operatorëve që marrin pjesë si JV në tender, do të kërkojnë për secilin edhe certifikimet përkatëse.

Së trembëdhjeti: OE ankimues në pikën e tetëmbëdhjetë të ankimit ka kërkuar sqarim mbi bazën ligjore të cituar në lidhje me grafikun e punimeve, i cili duhet të jetë në përputhje me zërat e punimeve dhe në përputhje me afatet kohore të publikuara në DST.

- Si lapsus është cituar Ligji i Vjetër LPP, por sigurisht do të korrigojë edhe kjo pjesë me ripublikimin e procedurës me preventivin bashkëlidhur dhe çdo kriter bazuar në legjislacionin në fuqi.

Së katërbëdhjeti: Për të gjitha pikat në vijim të cilat OE ankimues citon, mbi të cilat paraqet paqartësi mbi planorganizimin (pika e nëntëmbëdhjetë e kërkesës) numri i punonjësve, makineritë (pika e njëzet e një), zërat e grafikut të punimeve (pika e njëzet e dy).

- Sqarojmë se do të jenë pika të arsyeuara nga ana e AK në lidhje me preventivin që momentalisht mungon, duke bërë të mundur që ri-publikimi i kësaj procedure të ketë një përjasje të plotë të kriterëve me atë preventiv dhe legjislacionin në fuqi..”, duke mos pranuar këtë pretendim të ankimuesit.

III.12.4. Në nenit 77, pika 1, 2 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në

fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.12.5. Në nenit 79, pika 1 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”.

III.12.6. Në nenin 44, pika 1 dhe 4 “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

4. Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkojnë një certifikatë ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/të barasvlershme me të ose një dokument që provon të njëjtin informacion.”.

III.12.7.1. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet, se autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar edhe paraqitjen e certifikatës të sistemit për menaxhimin e integruar PAS 99 : 2012,

certifikatës të sistemit për menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor ISO 39001 : 2012, certifikatës të sistemit për menaxhimin e sigurisë së informacionit ISO 27001 – 2013, certifikatës të sistemit për menaxhimin e energjisë ISO 50001 – 2011, certifikatës së sistemit për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë informative ISO/IEC 20000 – 1:2018 dhe certifikatës së sistemit për menaxhimin për kushtet e cilësisë për shkrirjen e metaleve EN ISO 3834 – 2:2006. Komisioni i Prokurimit Publik, me qëllim verifikimin dhe marrjen e një informacioni sa më të saktë në lidhje me këto standardizime, kreu verifikimet në faqen e internetit të Organizatës Ndërkombëtare të Standardizimit (ISO), i cili është institucion i pavarur joshitetëror i njohur në nivel ndërkombëtar si organi i cili zhvillon dhe publikon standardet më të mira dhe që apdoptohen nga shtetet dhe organizatat kombëtare të standardizimit në shërbim të ekonomisë dhe të të gjitha palëve të interesuara, duke u siguruar atyre standardet e të gjitha fushave. Nga verifikimi në lidhje me standardizimin e mësipërm rezultoi, se certifikimi PAS 99 : 2012 lidhet me krijimin e një sistemi menaxhimi të integruar të organizatës, certifikimi ISO 39001 : 2012 lidhet me krijimin e një sistemi për menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor të organizatës, certifikimi ISO 27001 – 2013 lidhet me krijimin e një sistemi për menaxhimin e sigurisë së informacionit të organizatës, certifikimi ISO 50001 – 2011 lidhet me krijimin e një sistemi për menaxhimin e energjisë të organizatës, certifikimi ISO/IEC 20000 – 1:2018 lidhet me krijimin e një sistemi për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë informative të organizatës dhe certifikimi EN ISO 3834 – 2:2006 lidhet me krijimin e një sistemi për menaxhimin për kushtet e cilësisë për shkrirjen e metaleve të organizatës.

KPP konstaton, se në interpretim të normës ligjore të sipërcituar në nenin 79 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” kërkesat teknike lidhur me cilësinë i referohen edhe kualifikimeve të ofertuesve të mundshëm, pra kërkesa për paraqitjen e certifikatave të kualifikimeve të ofertuesve është një kërkesë që e parashikon legjislacioni për prokurimin publik, por me kushtin që këto certifikata të jenë në proporcion dhe të lidhura me objektin e prokurimit dhe njëkohësisht të mos jenë diskriminuese.

Nisur nga sa më sipër, KPP gjykon, se ndonëse kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e certifikatave të PAS 99 : 2012, ISO 39001 : 2012, ISO 27001 – 2013, ISO 50001 – 2011, ISO/IEC 20000 – 1:2018 dhe EN ISO 3834 – 2:2006 është një kërkesë e parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik, por njëkohësisht kjo kërkesë nuk është argumentuar nga ana teknike, pasi këto standarde nuk janë në përputhje dhe proporcion me objektin e prokurimit dhe konkretisht me natyrën e zërave të punimeve objekt-prokurimi, prandaj kjo kërkesë për kualifikim lidhur me paraqitjen e këtyre certifikimeve duhet të hiqet me rishpalljen e kësaj procedure prokurimi nga ana e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.12.7.2. Për sa i përket pretendimit të ankimuesit lidhur me kërkesën që në rastin kur ofertuesi paraqet ofertë si bashkim operatorësh ekonomik dhe secili prej anëtarëve të bashkimit të shoqërive duhet të paraqesë certifikatat PAS 99 : 2012, ISO 39001 : 2012, ISO 27001 – 2013, ISO 50001 – 2011, ISO/IEC 20000 – 1:2018 dhe EN ISO 3834 – 2:2006 nuk do të merren në

shqyrtim nga Komisioni i Prokurimit Publik, pasi kërkesa për disponimin e këtyre certifikatave do të hiqet me rishpalljen e kësaj procedure prokurimi dhe nuk ka më objekt-ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk merret në shqyrtim.

III.12.7.3. Për sa i përket pretendimit të ankimuesit për planin e organizimit dhe sigurisë në kantier autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1201/2 prot, datë 23.05.2022 ka sqaruar ankimuesin si në vijim: *“Për të gjitha pikat në vijim të cilat OE ankimues citon, mbi të cilat paraqet paqartësi mbi planorganizimin (pika e nëntëmbëdhjetë e kërkesës) numri i punonjësve, makineritë (pika e njëzet e një), zërat e grafikut të punimeve (pika e njëzet e dy).*

- Sqarojmë se do të jenë pika të arsyeuara nga ana e AK në lidhje me preventivin që momentalisht mungon, duke bërë të mundur që ri-publikimi i kësaj procedure të ketë një përjasje të plotë të kriterëve me atë preventiv dhe legjislacionin në fuqi.”.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor me rishpalljen e kësaj procedure prokurimi duhet të bëjë argumentimin e plotë të kriterit kualifikues lidhur me planin e organizimit dhe sigurisë në kantier në përputhje të plotë me volumin e zërave të preventivit dhe afatin kohor të kryerjes së saj.

III.13. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik *“LA PORTA DELLA LUCE”* ShPK ku kërkon: *“**Së njëzëti** kërkoni një deklaratë mbi mënyrën e financimit të objektit, por ndërkohë nuk keni publikuar se sa do të jetë financimi, për secilin vit, si dhe ku e keni të bazuar këtë lloj financimi, në cilën nen që mund të hapni një tender pa patur fondet në dispozicion. Pra, kërkojmë të na sqaroni ligjërisht, a mund të zhvillojë një AK një procedurë prokurimi në momentin që nuk ka fonde në dispozicion?”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.13.1. Në Shtojcën 7 *“FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT’* pika 2.3.10 *“Kapaciteti Teknik”* autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë:

“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose ti kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.”.

III.13.2. Lidhur me këtë pretendim të ankimuesit autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1201/2 prot, datë 23.05.2022 është shprehur se: *“Sa i takon pretendimit të njëzetë të OE ankimues në lidhje me deklaratën mbi mënyrën e financimit të objektit:*

Sipas Nenit 77 të LPP, legjitimohet AK të kërkojë çfarëdolloj dokumentacioni i cili do të “bindë” atë që OE ofertues ka kapacitet financiar për të mbuluar një punë. AK në zbatim të gjithë kuadrit ligjor në fuqi mbulohet me fonde të parashikuara për çdo zë prokurimi të miratuar me VKB, si dhe sipas regjistrave përkatës të publikuar në SPE. Zotërimi i fondeve për AK nuk është një problematikë që i takon OE, pasi ka ligje të posaçme që orientojnë institucionet për garantimin e fondeve të tyre.”, duke mos e pranuar këtë pretendim të ankimuesit.

III.13.3. Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” është përcaktuar përgjegjësia e autoritetit kontraktor, si më poshtë:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.13.4. Referuar metodës së interpretimit sistematik (*domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik*), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24/1 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së, si dhe neni 1 e 2 i VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe njëherazi përgjegjës për identifikimin e nevojave për investime blerje mallrash dhe shërbimesh, për përlllogaritjen e fondeve të nevojshme për realizimin e këtyre nevojave, për kohën e përzgjedhur nga ana e tyre për prokurimin e këtyre fondeve, si dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, parashikohet se *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*

KPP gjykon, se që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve (*legitimation ad causam*), pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se

interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjore për kundërshtimin e kritereve të veçanta të kualifikimit pranë këtij të fundit, duke u dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurat për fitimin e kontratave publike, do t'i nënshtrohen kushteve specifike (kritereve të veçanta të kualifikimit), të cilat duhet të përmbushin parakushtin *sine qua non* të parashikuar nga neni 77 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në rastin konkret, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është përgjegjës për identifikimin e nevojave për investime blerje mallrash dhe shërbimesh, për përlogaritjen e fondeve të nevojshme për realizimin e këtyre nevojave, për kohën e përzgjedhur nga ana e tyre për prokurimin e këtyre fondeve, hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik, si dhe për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit), duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik ku në nenin 118 gërma b të *lex specialis* parashikohet, se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të pranimit të ankesës dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

Në rastin konkret, KPP gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknike janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi veprime të autoritetit kontraktor, të cilat duhet të jenë në përputhje me përcaktimet VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe që është përgjegjësi e vetë autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë dhe në përgjegjësinë e autoritetit kontraktor identifikimi i nevojave për investime blerje mallrash dhe shërbimesh, përlogaritja e fondeve të nevojshme për realizimin e këtyre nevojave, koha e përzgjedhur nga ana e tyre për prokurimin e këtyre fondeve, hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik, realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, gjithmonë në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, por në rastin konkret edhe në përputhje me përcaktimet e VKB përkatëse në bazë të së cilës është bërë miratimi i fondit të investimit.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor me rishpalljen e kësaj procedure prokurimi duhet që të publikojë sqarimin lidhur me planin e investimit që ka autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi, me qëllim që operatorët ekonomikë të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë për këtë procedurë prokurimi të njihen dhe me mënyrën se si do të lëvrohet fondi për këtë procedurë prokurimi nga ana e autoritetit kontraktor, në mënyrë që vetë operatorët ekonomikë ofertues të krijojnë bindjen nëse kanë mundësi për të ofertuar ose jo për këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.14. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “LA PORTA DELLA LUCE” ShPK ku kërkon: “Së njëzet e një, kërkojmë nga KPP të verifikojë një e nga një të gjitha kërkesat për kualifikim, pjesë e DST, për të cilat kemi pretendimet tona se janë antiligjore, si dhe të na sqarojë se përse nuk i ka argumentuar AK çdo kërkesë për kualifikim tek procesverbali përkatës, por ka shkruar vetëm nene dhe ligje, por pa argumentuar teknikisht përse i ka kërkuar ato, p.sh. përse ka kërkuar 45 punonjës si del ky numër, përse ka kërkuar secilën nga makineritë, përse ka kërkuar hidraulikë dhe çfarë pune do të kryejë, në cilin pallat apo rrugë tjetër se këtu nuk ka asnjë zë, etj.

Së njëzet e dy, në lidhje me zërat e dhënë sipas grafikut të punimeve, rezulton se AK ka prokuruar zëra me njësi matëse gabim, e cila sjell si rrjedhojë edhe një fond limit mbase edhe fiktiv, mbase edhe të tejfryrë, si dhe të paargumentuar.

Kërkojmë nga KPP të bëjë verifikimin e saktë sipas projektit të dhënë nga AK dhe të na gjejë se ku do të hidhen 320 m³ beton C 16/20 dhe kjo vetëm për kuneta? Pra AK vetëm për kuneta do të harxhojë 320 m³ beton?

Pra AK, për 320 m³ beton do të harxhojë 0.7 ton hekur?

Për zërin shtresë çakulli mbeturinë kave, jepet njësia matëse në m², ndërkohë që referuar manualit të çmimeve në fuqi, njësia matëse e këtij zëri është në m³.

Atëherë, kërkojmë të saktësoni se ku është gjetur sasia prej 1500 m² dhe si do të jepet çmimi për këtë zë, ndërkohë që ky zë matet vetëm në m³? Pra, shikoni se si e kanë përlllogaritur vlerën e fondit limit.

Mos vallë jepet sasia në m² që të rritet fiktivisht vlera e fondit limit? Këtë përgjigje duam të na sqarojë KPP, përpara se kjo çështje të gjykohet edhe në instanca të tjera më të larta ligjzbatuese. Për zërin spërkatje me emulsion bituminoz jepet sasia 1500 m² për 1 L/m² dhe sasia 1500 m² për 0.5 L/m²?

Ndërkohë që sipas manualeve të ndërtimit në fuqi kur ka dalë kjo procedurë prokurimi, njësia matëse jepet vetëm në m², kërkojmë të sqarohet përse njësia matëse është dhënë në L?

Ku e ka gjetur AK sasinë prej 1500 L?

Po a e di AK se 0.5 L e 1500 është 750?

Po a e di AK se sipërfaqja sipas projektit që keni publikuar është 900 m², atëherë ku e keni gjetur sasinë prej 1500?

A e di AK se njësia matëse për gur dekorativ nuk është me KG?” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.14.1. Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” është përcaktuar përgjegjësia e autoritetit kontraktor, si më poshtë:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.14.2. Referuar metodës së interpretimit sistematik (*domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik*), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24/1 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së, si dhe neni 1 e 2 i VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar) dhe njëherazi përgjegjës për identifikimin e nevojave për investime blerje mallrash dhe shërbimesh, për përlllogaritjen e fondeve të nevojshme për realizimin e këtyre nevojave, për kohën e përzgjedhur nga ana e tyre për prokurimin e këtyre fondeve, si dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, parashikohet se *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*

KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve (*legitimation ad causam*), pra operatori ekonomik ankimes duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjore për kundërshtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit pranë këtij të fundit, duke u dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimes se procedurat për fitimin e kontratave publike,

do t'i nënshtrohen kushteve specifike (kriterëve të veçanta të kualifikimit), të cilat duhet të përmbushin parakushtin *sine qua non* të parashikuar nga neni 77 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në rastin konkret, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor përgjegjës për identifikimin e nevojave për investime blerje mallrash dhe shërbimesh, për përllogaritjen e fondeve të nevojshme për realizimin e këtyre nevojave, për kohën e përzgjedhur nga ana e tyre për prokurimin e këtyre fondeve, hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik, si dhe për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit) duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik, ku në nenin 118 gërma b të *lex specialis* parashikohet, se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të pranimit të ankesës dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

Në rastin konkret, KPP gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknike janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi veprime të autoritetit kontraktor, të cilat duhet të jenë në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe që është përgjegjësi e vetë autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë dhe në përgjegjësinë e autoritetit kontraktor identifikimi i nevojave për investime blerje mallrash dhe shërbimesh, përllogaritja e fondeve të nevojshëm për realizimin e këtyre nevojave, koha e përzgjedhur nga ana e tyre për prokurimin e këtyre fondeve, hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik, realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi, gjithmonë në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, por në rastin konkret edhe në përputhje me përcaktimet e VKB përkatëse në bazë të së cilës është bërë miratimi i fondit të investimit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “LA PORTA DELLA LUCE” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-29280-05-16-2022, me objekt: “Ndërtimi i Rrugëve të Brendshme në PMLAT”, me fond limit 15.833.333 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 06.06.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “LA PORTA DELLA LUCE” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit
 3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit.
 4. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në përputhje me konstatimet e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.
 5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “LA PORTA DELLA LUCE” SHPK.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri